



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINË
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD
WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE



RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË UJIT DHE TË MBETURINAVE 2009



VIZIONI

Shërbime cilësore dhe të qëndrueshme të ujësjellësit, kanalizimit dhe të mbeturinave për të gjithë qytetarët e Kosovës.

MISIONI

Të bëjë rregullimin e kompanive publike të ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave në funksion të ofrimit të shërbimeve cilësore, efikase dhe të sigurta në përputhje me praktikat e mira Evropiane, veçanërisht duke u fokusuar në promovimin e eficiencës, transparencës, shtrirjes së shërbimeve për të gjithë qytetarët, mbrojtjen e konsumatorëve me çmime sa më të përballueshme për shërbimet e ofruara gjithmonë duke pasur në konsideratë mjedisin dhe shëndetin publik.

PARATHËNIE



Ky është raporti i katërt vjetor i performancës i publikuar nga ZRRUM-i për performancën e kompanive të ofruesve të shërbimeve të Ujësellsit, Kanalizimit dhe Mbeturinave për vitin 2009.

Raporti ofron një pasqyrë vjetore objektive dhe të pavarur të performancës së kompanive të ujësellsit, kanalizimit dhe mbeturinave në Kosovë dhe ofron informata të besueshme për të gjithë akterët e ndërlidhur me shërbimet e ujësellsit, kanalizimit dhe mbeturinave, e që besojmë se janë të rëndësishme edhe për Kuvendin dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës, Komunat, Donatorët, Kompanitë e Ujit dhe Mbeturinave, me theks të veçant për konsumatorët.

Vlerësohet se rreth 66% e banorëve të Kosovës kanë qasje në furnizim me ujë të pijshëm që ofrohet nga kompanitë e ujësellsit, rreth 48% kanë shërbime të kanalizimit, ndërsa trajtimi i ujërave të zeza ende nuk ka filluar. Mbulueshmëria me shërbime të grumbullimit të mbeturinave është 42%.

Ruajtja e qëndrueshmërisë së shërbimeve ekzistuese është rrezikuar në mungesë të investimeve të nevojshme, e të cilat vështirë se do të sigurohen nga afarizmi aktual i kompanive, e si rezultat i kësaj shumica e ofruesve të shërbimeve të ujit vazhdojnë të jenë finaciarisht të paqëndrueshëm (në kufij të mbulimit të shpenzimeve operative).

Në vitin 2009, performanca e sektorit të shërbimeve të ujit në nivel të përgjithshëm ka shënuar trende negative për shumicën e treguesve kyç të performancës, shkalla e arkëtimit ka rënë nga 65% për vitin 2008 në 63% në vitin 2009, humbjet e ujit kanë shënuar ngritje nga 56% në vitin 2008 në 58% për vitin 2009, norma e mbulimit të punës po ashtu është në nivelin 0.97, do të thotë se kompanitë nuk kanë qenë në gjendje për ti mbuluar shpenzimet e tyre operative.

Përformanca e sektorit të mbeturinave është më brengosëse, trendet negativ janë sidomos te treguesit financiar, ku shkalla e arkëtimit ka rënë nga 61% në 55% për vitin 2009 dhe norma e mbulimit të punës si rezultat i të hyrave të pakta ka mbetur në nivelin e njëjtë në 0.87 në periudhën 2008-2009.

Është zhgënjyese për të theksuar se në vitin 2009 asnjë nga kompanitë e grumbullimit të mbeturinave (vetëm, Higjiena ka paguar për dy muaj të vitit 2009) nuk kanë paguar taksë vjetore të licencimit për ZRRUM-in. Ky është një pasqyrim i gjendjes së dobët finaciare të këtyre kompanive por njekohësisht tregon edhe mungesë respekti ndaj Ligjit Nr: 03/L-086 i cili është në fuqi.

Në pajtim me Kornizën Ligjore ZRRUM-i në vitin 2009 ka licencuar 15 kompani publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellsit dhe kanalizimit, shërbimet e furnizimit të ujit me shumicë dhe shërbimet e grumbullimit të mbeturinave. Validiteti i licencës së kompanive të ujësjellsit është për një periudhë tri vjeçare, ndërsa te kompanitë që ofrojnë shërbime të mbeturinave licenca është valide deri në nëntor të vitit 2010.

Nga fillimi i vitit 2009, ka filluar aplikimi i tarifave të reja të cilat për shërbime të ujit janë valide për një periudhë trevjeçare përderisa të shërbimet e mbeturinave për një periudhë njëvjeçare e të cilat kanë rezultuar me një ngritje në krahasim me tarifat e mëparshme. Kjo ngritje e tarifave është vlersuar si veprim i domosdoshëm për ti mundësuar kompanive gjenerimin e të hyrave të nevojshme për mbulimin e kostove të tyre dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve, por kjo nuk do të thotë se gjatë kësaj periudhe nuk do të ketë rishikim të tarifave.

Emërimi im si drejtor i ZRRUM-it, nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në prill të vitit 2010, më bënë të pasqyroj komente të njëjta mbi performancën për vitin 2009, sikurse edhe vitet e mëparshme.

Dua të potencoj se është zhgënjyese për të raportuar se performanca në pjesën më të madhe të treguesve për kompanitë e ujit dhe mbeturinave në përgjithësi është përkeqësuar gjatë vitit 2009, krahasuar me vitin 2008. Arsyet për një gjendje të këtillë mund të jenë komplekse dhe të njëjtat do të shqyrtohen fuqishëm në muajt e ardhshëm me të gjithë akterët e involvuar në sektorin e ujit dhe mbeturinave.

Është përgjegjësi e imja dhe stafit të ZRRUM-it, por edhe institucioneve të tjera që ti zbatojnë plotësisht rekomandimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, me rastin e miratimit të Raportit të Punës të ZRRUM-it për vitin 2009, në seancën plenare në Korrik të vitit 2010, rekomandime që janë të specifikuara dhe të cilat janë paraqitur në pjesën E të këtij raporti. Këto rekomandime ofrojnë një përmbledhje të qartë të prioritetëve për ZRRUM-in, Kompanitë dhe Institucionet e tjera për të ndihmuar ofruesit e shërbimeve të ujit dhe mbeturinave për një performancë më të mirë për periudhën vijuese.

Si në raportet e mëparshme ashtu edhe me këtë rast, në mungesë të konkurrencës së tregut për shërbimet e ujësjellsit dhe mbeturinave, kemi krahasuar performancën relative të kompanive duke u bazuar në treguesit kyç të performancës ku si rezultat i këtij krahasimi është bërë edhe rangimi i tyre.

Unë jam i kënaqur të konfirmoj se KRU 'Prishtina' është vlerësuar si kompania me performancën më të mirë në vitin 2009 ndërsa KRU 'Bifurkacioni' është shpallur kompania me përmisimet më të dukshme të performancës gjatë vitit 2009 krahasuar me vitin 2008. Sa i përket sektorit të grumbullimit të mbeturinave KRM 'Pastrimi' është vlerësuar si kompania me performancën më të mirë për vitin 2009 dhe KRM 'Uniteti' është vlersuar kompania me përmisimet më të dukshme të performancës gjatë vitit 2009.

Unë i përgëzoj këto kompani për performancën e tyre të treguar, njëherit i thërras kompanitë tjera për ngritje të mëtutjeshme të efikasitetit të tyre operativ si dhe cilësisë së shërbimeve.

Unë shpresoj se edhe donatorët si deri më tani do të sigurojnë mbështetje të nevojshme në lidhje me përmirësimin e performancës së kompanive. Po ashtu vlerësoj shumë mbështetjen e vazhdueshme të ofruar nga donatorët dhe kam besim se përpjekjet e kombinuara të stafit të ZRRUM-it, MEF-it (Njësia për Politika dhe Monitorim), Task Forcës së Ujit, stafit të KRU-ve dhe këshilltarëve të asistencës teknike të finacuar nga donatorët e që shpresoj se do të rezultojnë me përmisimin e problemit të arkëtimit dhe performancës së kompanive në periudhën pasuese.

Në fund jam i bindur se raporti vjetor i monitorimit të performancës do të jetë një mjet shumë i dobishëm për ti ndihmuar palët e interesit për të kuptuar punën e ofruesve të shërbimeve të ujësjellsit dhe mbeturinave si dhe të stimuloj konkurrencën duke synuar në përmisimin e vazhdueshëm të shërbimeve të ofruara.



Raif Preteni,

Drejtör i ZRRUM-it

PËRMBAJTJA

- | | |
|---------------|---|
| 1. Parathënie | 3 |
| 2. Hyrje | 7 |

Pjesa A

Zhvillimet në Sektorët e Ujit dhe të Mbeturinave	10
--	----

- | | |
|---|--|
| 3. Zhvillimet në Sektorët e Ujit dhe të Mbeturinave | |
|---|--|

Pjesa B

Performanca Krahasuese e Sektorit të Ujit

- | | |
|---|----|
| 4. Performanca e Përgjithshme e Sektorit të Ujësjetës dhe Kanalizimit | 17 |
| 5. Performanca Krahasuese Kompanive Rajonale të Ujësjetës | 25 |
| 6. Përgjegjshmëria e KRU ndaj ZRRUM-it | 53 |
| 7. Realizimi i Investimeve Kapitale | 54 |
| 8. Performanca e Furnizuesit të Ujit me Shumicë | 55 |
| 9. Komente dhe Rekomandime për Kompanitë Rajonale të Ujësjetës dhe Kanalizimeve | 56 |

Pjesa C

Performanca Krahasuese e Sektorit të Mbeturinave

- | | |
|--|----|
| 10. Performanca e Përgjithshme e Sektorit të Mbeturinave | 60 |
| 11. Performanca Krahasuese e Kompanive Rajonale të Mbeturinave | 67 |
| 12. Performanca e Kompanisë së Deponimit të Mbeturinave | 77 |

Pjesa D

Aktivitetet e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve

- | | |
|---|----|
| 13. Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve | 79 |
|---|----|

Pjesa E

Rekomandime

- | | |
|---------------------------------|----|
| 14. Rekomandime të Përgjithshme | 83 |
|---------------------------------|----|

Shtojca:

- Shtojca 1
- Të dhënat Statistikore
- Shtojca 2
- Detalet Kontaktuese
- Shtojca 3
- Zonat e Shërbimeve

AKRONIMET DHE SHKURTESAT

BB	Banka Botërore
ESK	Enti i Statistikave të Kosovës
IKSHPK	Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik të Kosovës
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
KKK	Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
KRM	Kompanitë Rajonale për Mbeturina
KRU	Kompanitë Rajonale të Ujit
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë
NHP –IL	Kompania Hidroekonomike Ibër-Lepenci
NJPM-NP	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
PSP	Participimi i Sektorit Privat
ROFK	Raporti Operativ, Financiar dhe Shërbimeve ndaj Konsumatorëve
SCO	Zyra Zvicerane për Bashkëpunim
TFU	Task Forca e Ujit
TKP	Treguesit Kyç të Performancës
UPF	Uji i pa Faturuar
USAID	Agjencioni Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtar
ZNKE	Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian
ZRRUM	Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Mbeturina

HYRJE

Raporti i monitorimit të performancës së ofruesve të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave është përgatitur nga ZRRUM-i dhe ka për qëllim dhënien e informatave të nevojshme për çdo furnizues të shërbimeve veç e veç dhe të sektorëve në përgjithësi në Kosovë, për të vlerësuar performancën e furnizimit me ujë, shërbime të kanalizimit si dhe grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave. Po ashtu në këtë raport mund të sigurohen dhe informata të tjera me rëndësi për zhvillimet në sektorin e ujit dhe mbeturinave në Kosovë.

Raporti përbëhet prej pesë pjesëve, A, B, C, D dhe E. Në pjesën A jepet një informacion në lidhje me zhvillimet në këta sektorë të ndodhura në vitin 2009. Pjesa B dhe C paraqesin pjesën qendrore të raportit në të cilat analizohet performanca e sektorit të ujit dhe mbeturinave, të cilat janë nën mandatin rregullatorë të ZRRUM-it, duke vazhduar në pikën D me aktivitetet e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve dhe në pjesën E ku janë dhënë rekomandime të përgjithshme për përmirësimin e gjendjes në këta sektorë me rekomandime të veçanta për Kompanitë, Qeverinë dhe Komunitet. Në pjesën e veçantë, janë dhënë disa shtojca të cilat përmbajnë të dhëna themelore statistikore dhe detaje kontaktuese për sektorin e ujit dhe të mbeturinave, të cilat mund të ju shërbejnë palëve të tjera të ndërlidhura me këta sektorë.

Raporti paraqet një suitë të plotë të treguesve të punës dhe të dhënave statistikore për të gjitha kompanitë, jep informacione krahasuese të performancës gjatë viteve 2008/2009, si dhe mesataren e sektorit në përgjithësi.

Ky raport është një burim i rëndësishëm i informacioneve për të gjitha palët e interesit përfshirë: **(i)** konsumatorët, për të parë nivelin e shërbimeve të cilat atyre ju ofrohen, **(ii)** menaxherëve dhe të punësuarve në kompani për të identifikuar fushat për përmirësim dhe përcaktimin e synimeve reale si dhe krahasimin e performancës së tyre aktuale me punën e viteve të mëparshme ose me punën e kolegëve të tyre në sektor, **(iii)** institucioneve vendore (Kuvendin, Qeverinë, Pushtetin Lokal), për të drejtuar dhe ndikuar në politikat e nevojshme me qëllim të krijimit të sektorëve të qëndrueshëm, **(iv)** donatorët për ti orientuar investimet në vendin më të qëlluar dhe **(v)** mediat për të pasur informata të sakta dhe të besueshme.

Për më tepër raportimi te publiku i gjerë kontribuon në ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies dhe paraqet një mekanizëm i cili mund të nxitë konkurrencën në tregun e shërbimeve të cilat në Kosovë veprojnë në kushtet e monopolit të plotë.

Në përputhje me obligimet raportuese që kanë ofruesit e shërbimeve ndaj ZRRUM-it është krijuar një bazë e të dhënave (DB) që i përfshijnë aspektet e ndryshme të punës së tyre si operative, financiare dhe të shërbimeve të konsumatorëve. Të dhënat raportohen në baza mujore nga ofruesit e shërbimeve sipas formatit të Raportit Operativ Financiar dhe Shërbime ndaj Konsumatorëve (ROFK).

Të dhënat e shfrytëzuara për analizën e kualitetit të ujit janë raportuar nga IKSHPK po ashtu në baza mujore në përputhje me një marrëveshje bashkëpunimi në mes të ZRRUM-it dhe IKSHPK-ës, si dy institucione me përgjegjësi të caktuara për furnizim të sigurt me ujë të pijshëm për konsumatorët në Kosovë.

Kualitetin e të dhënave ZRRUM-i e siguron përmes auditimit që stafi i saj e ndërmerr çdo vit, i cili është gjithëpërfshirës dhe sistematik duke përfshirë të dhënat operative, financiare dhe ato lidhur me shërbimet ndaj konsumatorëve, që raportohen në ZRRUM si dhe aspektet të tjera të punës së kompanive.

Në mënyrë specifike auditimi i kryer nga ekipi i auditimit është përqëndruar në:

- Kontrollimin e të dhënave në sistemin informativ të kompanive, me qëllim që të verifikojë përputhshmërinë e të dhënave të raportuara përmes ROFK, në raport me të dhënat faktike në sistemin informativ të kompanisë,
- Analizimin e sistemit të mbajtjes dhe raportimit të të dhënave për t'u siguruar se i njëjti mundëson gjenerimin e të dhënave të sakta dhe të verifikueshme,
- Analizimin e procedurave interne të kompanive, për të vlerësuar se sa ato janë konsistente me obligimet ligjore të kësaj kompanie të përcaktuara me rregullat e ZRRUM-it, si dhe Licencën e Shërbimit,
- Inspektimin e kushteve të pranimit, shqyrtimit, dhe kthimit të ankesave të konsumatorëve, si dhe çështje të tjera.

Të dhënat e raportuara verifikohen/auditohen, analizohen dhe si të tilla shërbejnë si bazë për përgatitjen e raporteve të performancës mbi sektorin e ujit dhe mbeturinave.

Të dhënat financiare konsiderohen plotësisht të sakta, përderisa të dhënat operative dhe të shërbimit ndaj konsumatorëve ende nuk janë plotësisht të sakta. Megjithatë ka përmirësime nga viti në vit, ende raportohen disa të dhëna të vlerësuara dhe jo shumë të sakta, në veçanti të dhënat për popullsinë, disa të dhëna operative dhe ato të shërbimit ndaj konsumatorëve. Për këtë arsye ato nuk janë përfshirë në llogaritjen e disa treguesve të rëndësishëm. Duhet cekur se pjesërisht këto pasaktësi vijnë për shkak të mos përdorimit të mundësive të cilat i mundëson teknologjia e kohës, por disa janë edhe për shkak të nivelit jo të kënaqshëm të përgjegjësisë së disa zyrtarëve të involvuar në procesin e raportimit të të dhënave.

Të dhënat e raportuara shërbejnë si bazë për të llogaritur një numër të konsiderueshëm të treguesve të punës të cilët monitorohen vazhdimisht për secilin ofrues dhe më pas krahasohen ndërmjet tyre. Vlerësimet bëhen në bazë të treguesve kyç të performancës (TKP), të cilët konsiderohen se janë më të besueshëm, janë më të rëndësishëm si dhe janë nën ndikimin e menaxhmentit të kompanisë. Ngjashëm me vitin e kaluar edhe këtë vit është përdorur metodologjia e njëjtë e vlerësimit, sa i përket numrit të TKP, peshës së treguesit si dhe besueshmërisë së të dhënave të përdorura për llogaritjen e tyre.

Pjesa A

Zhvillimet në Sektorët e Ujit dhe të Mbeturinave

3. ZHVILLIMET NË SEKTORËT E UJIT DHE TË MBETURINAVE

3.1 Zhvillime të përgjithshme

Në Kosovë sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm, shërbime të kanalizimit, dhe të furnizimit të ujit me shumicë është sistem publik.

Kompanitë publike të cilat veprojnë në këtë sektorë i janë nënshtruar reformave të brendshme (procesi i konsolidimit dhe ristrukturimi është përfunduar në vitin 2006) me qëllim të shkrirjes dhe bashkëpunimit më të ngushtë të tyre, ku nga një numër i njësive të vogla operative u krijuan shtatë kompani rajonale të ujësjellësit dhe kanalizimit. Aktualisht kompanitë rajonale ofrojnë shërbimet e tyre në 27 komuna të Kosovës në bazë të marrëveshjeve për shërbime të nënshkruar nga komunat respektive. Ato kanë statusin e shoqërive aksionare, pronare e të cilave është Republika e Kosovës¹ përveç KRU Bifurkacioni² (ku pronare janë komunat Ferizaj dhe Kaçanik), në përputhje me Ligjin, Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Në kuadër të reformave të mëhershme në sektorin e ujit dhe të mbeturinave është instaluar korniza rregullatore dhe në bazë të ligjit Nr. 03/L-86 të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës më 13 qershor 2008, ZRRUM është përgjegjës për rregullimin e ndërmarrjeve publike që ofrojnë shërbime të ujësjellësit, kanalizimit, mbledhjes së mbeturinave dhe deponimit të mbeturinave, në konteste të përcaktimit të tarifave të shërbimeve, lëshimin e licencave për ofruesit e shërbimeve, përcaktimi dhe mbikëqyrja e standardeve të shërbimit, monitorimin dhe raportimin e performancës së ofruesve të shërbimeve, themelimin dhe përkrahjen e KKK, si dhe miratimin e kushteve për faljen e borxheve të vjetra.

Në Kosovë ka një numër të ujësjellësve rural të ndërtuar nga organizatat donatore dhe komunitetet, të cilat nuk janë në menaxhimin e kompanive qendrore e të cilat në të shumtën e rasteve mirëmbahen nga komunitetet. Më qëllim që të menaxhohen në përputhje me standardet minimale të shërbimeve ato duhet të inkorporohen në ujësjellësit qendrorë.

Në Kosovë aktualisht nuk ka trajtim të ujërave të zeza, ato vetëm grumbullohen përmes sistemit të kanalizimit dhe pa ndonjë trajtim të mëtijshëm derdhen në lumenj.

Në bazë të ligjit për ndërmarrjet publike, Nr. 03/L-087, është formuar Njësia për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike në kuadër të MEF me qëllim të mbikëqyrjes së afarizmit të NP.

¹ Qeveria e Kosovës ka kompetencën për ushtrimin e të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës për Kompanitë Rajonale Qendrore.

² Komisioni Komunal i Aksionarëve ushtron të drejtat e aksioneve të Komunave.

Në vitin 2009, nga Qeveria janë konstituar Bordet e Drejtorëve (BD) për të gjitha KRU-të, në përputhje me ligjin për ndërmarrjet publike dhe njëherit i'u janë caktuar përgjegjësitë kryesore mbi ndërmarrjet publike.

Me iniciativën e Qeverisë së Kosovës, në fillim të vitit 2009 ka filluar puna e Task Forcës së Ujërave (TFU) e cila është duke u mbështetur nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim, si udhëheqëse e donatorëve për sektorin e ujërave. TFU udhëhiqet nga zv.Kryeministri i Kosovës dhe përbëhet nga katër Ministra të ndërlidhur me sektorin e ujit (MMPH, MEF, MAPL dhe MPJ), përfaqësues të komunitetit të donatorëve (pa drejtë vote) dhe përkrahjet nga Këshilltarët për Politika Ujore dhe për Ndërmarrje Ujore. Qeveria e Kosovës përmes TFU ka shprehur përkushtimin e saj për rritjen e angazhimeve në sektorin e ujit.

Çështjet e adresuara përmes TFU-së në përgjithësi në sektorin e ujërave kanë të bëjnë me zhvillimin e politikave në sektorin e ujit, përkrahje në hartimin e strategjisë së ujërave, plotësimin dhe harmonizimin e kornizës ligjore dhe institucionale, përgatitjen e planeve investive për sektorin e ujërave, hartimin e politikave për involvimin e sektorit privat në sektorin e ujërave, zhvillimin e kapaciteteve akademike në sektorin e ujërave, nisjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në sektorin e ujërave, koordinimin ndër institucional si dhe të donatorëve.

Çështjet tjera të adresuara përmes TFU-së në sektorin e shërbimeve të ujit janë, hartimi i politikave për qeverisje korporative, hartimi dhe implementimi i marrëveshjes për performancën, hartimi i politikës për subvencionimin e KRU-ve në emër të pagesës së faturave për ujin e konsumuar nga kategoria e rasteve sociale, konsolidimi i ndërmarrjeve të ujësjellësve publik në komunat e sapo formuara, zhvillimi i politikave për sistemet rurale të furnizimit me ujë, si dhe gjetja e modaliteteve për ngritjen e shkallës së arkëtimit. Me bashkëpunimin e ndërsjellë në mes të NJPM-NP, TFU, ZRRUM-it, dhe KRU është finalizuar draft marrëveshja mbi performancën e cila do të implementohet nga fillimi i vitit 2011 për arritjen e caqeve në treguesit kryesor të performancës.

Komuniteti i donatorëve në mënyrë aktive është duke e mbështetur sektorin e shërbimeve të ujit në Kosovë përmes disa prej donatorëve më të fuqishëm siç janë KE përmes Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian (ZNKE), Banka Gjermane për Zhvillim (KfW), Zyra Zvicerane për Bashkëpunim (SCO). Banka Botërore (BB), Agjencioni Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtarë (USAID), etj. Donatorët kanë përkrahur një numër të aktiviteteve përmes investimeve në infrastrukturën ujore si në zona urbane ashtu edhe rurale, sidomos në rritjen e kapaciteteve prodhuese, investimeve në rrjetat shpërndarëse, mbulueshmërinë me shërbime, etj. Këto programe janë plotësuar me ndihma në ngritje institucionale për KRU dhe institucionet e ndryshme përgjegjëse në sektorin e ujërave.

ZRRUM-i është përkrahur nga SCO, në programin e Monitorimit dhe Vlerësimit Krahësues për KRU, gjatë viteve 2008 deri në gjysmën e parë të vitit 2010.

Problemet e natyrës politike me komunat në pjesën veriore (Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok), ende nuk janë tejkaluar, duke i reflektuar ato probleme edhe te kompanitë të cilat ofrojnë shërbime të furnizimit me ujë dhe të mbeturinave, e të cilat kanë mbetur jashtë procesit të konsolidimit dhe rajonalizimit. Këto kompani po ashtu nuk i janë nënshtruar rregullativës ekonomike të cilën e zbaton ZRRUM-i.

Kompania rajonale Mitrovica, është gjetur në pozitë të vështirë nga kjo gjendje ku që nga pas lufta mbi 20% e ujit të prodhuar nga KRU Mitrovica është dërguar tek kompanitë në pjesën veriore prej të cilave deri më tani nuk ka marrë ndonjë kompenzim. Me qëllim të mbulimit të shpenzimeve për ujin e dërguar në pjesën veriore kompania subvencionohet pjesërisht nga Qeveria e Kosovës, mjete të cilat sipas kompanisë në fjalë nuk i mbulojnë tërësisht shpenzimet që krijohen për prodhimin e kësaj sasive të ujit, ku si pasojë në instancën e fundit KRU Mitrovica ballafaqohet me mungesë të qëndrueshmërisë financiare si dhe të furnizimit të rregullt me ujë.

Në Kosovë sistemi i grumbullimit të mbeturinave si dhe deponimi i tyre, aktualisht ofrohet nga kompanitë publike po ashtu i organizuar në baza rajonale.

Në baze të ligjit për ndërmarrjet publike Nr. 03/L-087, pronarë të kompanive për grumbullimin e mbeturinave janë Komunat. Procesi i kalimit të kompetencave tek komunat, i filluar me Ligjin mbi Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike, është duke vazhduar, megjithatë nuk është e qartë se si aktualisht këto kompetenca do të aplikohen në praktikë me rastin e shërbimit të mbeturinave ku çasja e deritanishme ka qenë rajonale e jo lokale.

Presioni i sektorit privat edhe me tutje është duke u rritur që edhe ata të marrin pjesë plotësisht në ofrimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave në të ardhmen e afërt. Megjithatë, participimi i sektorit privat (PSP) ende është i kufizuar për shkakun e vonesave në implementimin e ndryshimeve të propozuara legjislativë dhe të forcimit të masave institucionale.

3.2 Licencimi i ofruesve të shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave

Në pajtim me kuadrin aktual ligjor, ZRRUM-i gjatë viti kalendarik 2009 ka zhvilluar procesin e licencimit të ofruesve të shërbimit të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe ofruesve të shërbimit për grumbullimin e mbeturinave, me ç'rast janë licencuar 15 (pesëmbëdhjetë) ofrues të shërbimeve në pronësi publike prej të cilave:

- Kompani rajonale të ujësjellësit dhe të kanalizimit, 7 (shtatë),
- Kompania e furnizimit me ujë të patrajtuar, me shumicë-Iber Lepenci 1 (një),
- Kompani rajonale të mbeturinave, 7 (shtatë).

Gjatë procesit të licencimit ZRRUM-i, ka konstatuar se aplikuesit për licencë të shërbimit janë ballafaquar me një varg problemesh dhe vështirësish sikurse janë; dekonsolidimi i disa njësive operative (Komunave), të cilat ZRRUM-i konsideron si të një anshme dhe të kundërligjshme (Komunat Deçan, Viti dhe Kaçanik), problemet me qëndrueshmërinë financiare (mos mundësia e arkëtimit të faturave të lëshuara), si

dhe mos mundësia e plotësimit të kriterëve për licencim të kërkuara me kornizën aktuale ligjore.

ZRRUM-i duke pasur parasysh këto probleme ka lëshuar licenca shërbimi për ofruesit e shërbimit të ujësjellësit dhe kanalizimit në kohëzgjatje trevjeçare³, gjersa ofruesve të shërbimit për grumbullimin e mbeturinave në kohëzgjatje njëvjeçare.

Në aspektin e avancimeve të kornizës aktuale ligjore, janë ndërmarrë aktivitete për amandamentimin e legjislacionit primar dhe atij sekondar, respektivisht amandamentimin e Ligjit Nr.03/L-086 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut mbi veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave i cili ende nuk është arritë që të finalizohet, si dhe amandamenti i legjislacionit sekondar (rregullave).

Duke u nisur nga trendet aktuale në shoqërinë tonë pritet që edhe në këta sektorë të kyçen operatorët privat, për të cilin ka interesim shumë të madh ndërsa ZRRUM-i konsideron se ai është institucion kompetent dhe përgjegjës (analog Rregullatorëve në vendet e tjera) për rregullimin gjithashtu dhe të sektorit privat.

3.3 Aprovimi i tarifave për shërbimet e ujit dhe të mbeturinave

Pas procesit të konsolidimit që ka ndodhur në sektorët e shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave tarifat për ujë të pijshëm, shërbime të kanalizimit dhe të mbeturinave janë harmonizuar për çdo zonë të furnizimit të kompanive rajonale.

Nga fillimi i vitit 2009 ka filluar aplikimi i tarifave të reja për shërbimet e ujit të cilat janë valide për një periudhë trevjeçare kurse aprovimi i tarifave të reja nga ZRRUM-i ka rezultuar me një ngritje të tyre në krahasim me tarifat e mëparshme.

Në kuadër të sektorit të ujësjellësit dhe kanalizimit, mesatarja e tarifave volumetrike për vitin 2008 për konsumatorët shtëpiak ishte 0.28 €/m³, kurse për vitin 2009 është ngritur në 0.31 €/m³, shprehur në përqindje është një rritje për 10.72%, përderisa për konsumatorët jo shtëpiak tarifa volumetrike e ujit ka qenë 0.59 €/m³ dhe e njëjta është ngritur në 0.68 €/m³, apo 15.26% më e lartë në vitin 2009.

Tarifat tek sektori i mbeturinave janë aprovuar për një periudhë njëvjeçare. Për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave, tarifa mesatare për konsumatorët shtëpiak në vitin 2008 ka qenë 3.55 € /muaj dhe e njëjta është ngritur në 3.81 € /muaj për vitin 2009, shprehur në përqindje kjo është një rritje prej 7.32%.

Kjo ngritje e tarifave është e para në tri vitet e fundit dhe është vlerësuar si absolutisht e domosdoshme për t'iu mundësuar kompanive gjenerimin e të hyrave të nevojshme, për mbulimin e kostove operative dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve.

³ Me legjislacionin aktual licencat e shërbimit mund të lëshohen në kohëzgjatje jo më pak se 1 (një) vit e jo më shumë se 5 (pesë) vjet, përveç licencave të shërbimit për deponimin e mbeturinave të cilat mund të lëshohen në kohëzgjatje jo më shumë se 10 (dhjetë) vjet.

Është me rëndësi të theksohet se me aprovimin e tarifave të reja nga mjetet financiare të kompanive dhe të donatorve janë paraparë të ndërmirren investime të konsiderueshme gjatë viteve 2009-2011, nga të gjitha kompanitë e ujësjellësit, në vlerë totale mbi 140 milion euro, investime këto që janë të domosdoshme në sistemet e ujësjellësit dhe kanalizimit të cilat do të mundësojnë shërbime më cilësore për konsumatorët. Pjesa më madhe e investimeve kapitale pritet të financohen nga donacionet dhe grandet, ndërsa vlera prej 23 milion euro e mbuluar me tarifat e këtij procesi, të cilat janë planifikuar të investohen nga të hyrat vetanake të kompanive është një hap i rëndësishëm. Realizimin e këtyre investimeve ZRRUM-i e ka monitoruar gjatë vitit 2009 për të parë se sa ato janë duke u realizuar si në vlerë ashtu edhe në dinamikën e paraparë. Në përputhje me progresin e arritur në drejtim të realizimit të tyre, ZRRUM-i mund të merr në konsiderim rishqyrtimin e tarifave në vitet e ardhshme.

3.4 Zhvillimet në Procesin tarifor prej 1 Janar 2009

Që nga fundi i 2007 ZRRUM, ka punuar me ofruesit e shërbimeve të ujit dhe mbeturinave për të arritur një ndryshim thelbësor në bazën e përcaktimit të tarifave. Në vitet e para të rregullimit ekonomik të sektorit të ujit, kur kompanitë e licensuara ishin ende duke u njohur me konceptet rregullative, tarifat caktoheshin në baza vjetore dhe përcaktoheshin me metodën e mbulimit të kostos. Edhe pse ZRRUM-i, ka kërkuar gjithmonë të nxisë investimet në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit, në praktikë kompanitë e licensuara kanë gjeneruar vetëm rrjedhje marginale të parave të gatshme për të financuar investimet, në pjesën më të madhe ata kanë dështuar të përmbushin edhe objektivat e thjeshta të arkëtimit të parave të gatshme. Normat e mbulimit të punës të paraqitura në këtë raport janë afër ose nën 1.0 për të gjitha kompanitë, që e konfirmon këtë analizë. Për këtë arsye kompanitë janë mbështetur kryesisht në grantet nga donatorët për çdo investim të konsiderueshëm. Pa dyshim, nivelet aktuale të investimeve në sektorin e ujit nuk janë të mjaftueshme as për të ruajtur gjendjen e tanishme.

Me qëllim të nxitjes së investimeve, planifikimit afatmesëm dhe rritjes së transparencës së tarifave, ZRRUM, duke u konsultuar gjerësisht me palët e interesit, ka prezantuar ndryshimet e mëposhtme në metodologjinë e tarifave në sektorin e ujit të Kosovës që kanë hyrë në fuqi prej 1 Janar 2009:

- Kalimi nga tarifat vjetore në periudhën tre-vjeçare të shqyrtimit të tarifave (2009-2011). Kjo do të ngritë ndjeshëm sigurinë rregullative, dhe për këtë arsye do të inkurajojë planifikimet afatmesme. Mundësia që kompanitë të mbajnë përfitimet financiare me të tejkaluar objektivat në të gjithë periudhën e rishqyrtimit duhet gjithashtu të ndihmojë për të ofruar përmirësim të konsiderueshëm të performancës komerciale.
- Prezantimi i Kthimit mbi Vlerën Rregullatore të Kapitalit. Kjo do të i lejojë kompanitë për të arritur një nivel të arsyeshëm të fitimit përveç mbulimit të kostos, dhe për këtë arsye do të sigurojë rrjedhje shtesë të parave të gatshme

për të financuar programet e investimeve, dhe për të nxitur kompanitë për të ruajtur bazat e tyre të kapitalit.

- Kontimi i veçantë dhe përcaktimi ndaras i tarifave në mes të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve. Kjo do të sigurojë transparencë më të madhe dhe drejtësi në nivelet e tarifave, dhe do të drejtojë menaxhmentin në fokusim më të mprehtë.

Në të njëjtën kohë duke kërkuar që të përmirësohet performanca e rrjedhës së parasë të kompanive, ZRRUM mbron interesat e konsumatorëve duke vendosur objektiva sfiduese të performancës, veçanërisht për Ujin e pa faturuar dhe Efikasitetin e arkëtimit, dhe duke këmbëngulur se rrjedhja e planifikuar e parave shtesë të ri-investohet në rrjetë.

Përcaktimi i tarifave për 2009-2011, ishte hera e parë që ZRRUM kishte vendosur objektiva të qarta për kompanitë, dhe në përputhje me rrethanat ky raport shkon përtej një analize të ecurisë historike, ashtu si në të kaluarën, dhe shqyrton performancën aktuale edhe kundrejt objektivave. Prandaj diagramet e paraqitura në Pjesën B, përfshijnë jo vetëm të dhënat për vitin 2009 dhe 2008, por edhe të dhënat mbi objektivat në rastet e treguesve në vijim:

- Uji i pa faturuar (%)
- Uji i pa faturuar (m³/kons/muaj)
- Shkalla e arkëtimit (%),
- Norma e mbulimit të punës
- Norma e punës.

Pjesa B

Performanca Krahasuese e Sektorit të Ujit

4. PERFORMANCA E PËRGJITHSHME E SEKTORIT TË UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT

4.1 Performanca e sektorit të shërbimeve të ujit

Sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizim në Kosovë është i organizuar në baza rajonale. Nga ZRRUM-i, janë licencuar shtatë kompanitë rajonale për të ofruar shërbime të cilat njëkohësisht ofrojnë shërbime të ujësjellësit dhe të kanalizimit dhe një kompani që ofron furnizim me ujë të patrajtuar me shumicë për dy kompani rajonale.

Në tabelën 1. është dhënë një profil i shkurtër i kompanive rajonale të shoqëruara me shkurtesat e emrave të tyre të cilat përdoren më tutje në raport.

Tabela 1. Profili i kompanive rajonale të ujësjellësve-kanalizimeve

Emri i kompanisë	Komunat në zonën e shërbimit	Popullata totale në zonën e shërbimit (x1000)	Popullata e shërbyer me ujësjellës (x1000)	Popullata e shërbyer me kanalizim(x1000)	Numri i konsumatorëve	Prodhimi total i ujit në ml/m ³	Numri i të punësuarve	Emertimi i përdorur
KRU, Prishtina, Sh.a	7	580	467	348	86,491	45.1	497	Prishtina
KRU Hidroregjioni Jugor, Sh.a	4	390	192	170	31,230	15.2	189	Hidroregjioni Jugor
KRU Hidrodrini, Sh.a	5	244	185	96	30,896	28.2	176	Hidrodrini
KRU Mitrovica, Sh.a	3	212	135	104	21,314	17.3	219	Mitrovica
KRU Radoniqi, Sh.a	2	167	162	105	27,230	15.2	218	Radoniqi
KRU Hidromorava, sh.a	3	263	86	82	16,676	6.9	92	Hidromorava
KRU Bifurkacioni, sh.a	2	147	86	64	13,964	5.1	145	Bifurkacioni
Totali	26	2,002	1,312	969	227,801	133	1,536	

Popullata e pëgjithshme e Kosovës vlerësohet të jetë 2,104,540⁴, prej të cilëve 2,001,908, banorë vlerësohet se jetojnë në zonat e shërbimit ku veprojnë ofruesit e shërbimeve, prej të cilëve 1,311,648 banorë kanë qasje në shërbime të ujësjellësit dhe 969,194 banorë në shërbime të kanalizimit.

Monitorimi përfshinë 7 (shtatë) KRU të cilat ofrojnë shërbime në 26 komuna të Kosovës përmes njësive operative. Mbulueshmëria me shërbime të ujit nga Kompanitë rajonale është 66%, ndërsa me shërbime të kanalizimit rreth 48%, Megjithatë, 34% e popullsisë ende nuk kanë qasje në shërbime të ujësjellësit të ofruara nga kompanitë publike dhe 52% nuk kanë shërbime të kanalizimit. Akses i ulët në kanalizime dhe trajtim të ujërave të zeza, krahasuar me progresin e arritur në furnizimin me ujë, është një zonë me interes për investime.

Në vitin 2009 janë prodhuar 133,089,834m³, ujë të pijshëm i cili është distribuar tek konsumatorët dhe nga tërë uji i prodhuar 77,192,101m³, janë humbur dhe keqpërdorur që d.m.th uji i cili nuk sjellë të ardhura për kompaninë përderisa mbi 8,491,131€ janë shpenzime në emër të ujit të pafaturuar.

Edhe më tej rreth 20% e konsumatorëve nuk janë të pajisur me ujëmatës dhe se faturimi i tyre bëhet në mënyrë paushalle ndërsa nëse merret në konsideratë se një numër i caktuar i ujëmatësve janë jo funksional (fakt i dalur edhe nga inspektimi⁵ i ndërmarrë nga ZRRUM-i), del se proporcioni i konsumatorëve të cilët nuk janë pajisur me ujëmatës funksional është edhe më i lartë se 20%.

Shkalla e arkëtimit prej 63%, ka kushtëzuar që norma e mbulimit të punës të jetë 0,97 duke i lënë kompanitë nën kufirin e mbulimit të shpenzimeve operative dhe të pa afta financiarisht për të bërë investime në zëvendësimin apo rritjen e aseteve.

Shumat mesatare të akumuluar nga konsumatorët për shërbimet e ofruar për kompani në vitin 2009 janë 10,235,076€ ndërsa obligimet e akumuluar ndaj kreditorëve janë 2,377,104€.

Numri i punëtorëve të punësuar në Kompanitë rajonale është 1,536 dhe ka tendencë të rritjes krahasuar me vitin 2008 për 0.7 %, megjithëse efikasiteti i stafit ka trend të lehtë pozitiv por norma e tij prej 6.7 mbetet ende e lartë.

⁴ Kjo shifër është marrë nga një analizë e ESK -Analiza e statistikave vitale të Kosovës për periudhën më të re.

⁵ Inspektimi i leximit të ujëmatësve individual në zonën e shërbimit të KRU, Hidromorava, Bifurkacioni, Prishtina dhe Mitrovica.

4.2 Performanca dhe rangimi i kompanive rajonale të ujit

Treguesit kyç të performancës (TKP) për sektorin e ujësjellësit dhe kanalizimeve përmes të cilëve është bërë vlerësimi dhe rangimi i KRU-ve për performancën më të mirë në vitin 2009 si dhe për progresin më të madhë të shënuar në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 janë:

- Shkalla e arkëtimit
- Uji i pafaturuar (UPF)
- Norma e mbulimit të punës
- Ankesat e konsumatorëve
- Kualiteti i ujit
- Eficienca e stafit
- Konsumi i matur
- Kostoja për njësi
- Rritja e numrit të konsumatorëve

Tabela 2. Niveli i arritur i TKP sipas kompanive dhe mesatarja e sektorit në 2009

Kompanitë rajonale të ujësjellësve	Shkalla e arkëtimit (%)	Uji i pafaturuar (%)	Norma e mbulimit të punës	Ankesat e konsumatorëve (nr./1000 Kon)	Kualiteti i ujit (%)	Efikasiteti i stafit (staf/1000kon)	Konsumi i matur (%)	Kostoja për njësi (€/m ³)
Prishtina	65%	54%	1.06	32.0	2.0%	5.75	90%	0.14
Hidroregjioni Jugor	60%	55%	0.88	25.1	3.9%	6.05	87%	0.12
Hidrodrini	60%	74%	1.03	58.2	8.3%	5.70	93%	0.05
Mitrovica	51%	51%	0.67	-	2.4%	10.27	71%	0.10
Radoniqi	69%	55%	1.02	59.2	0.7%	8.01	79%	0.12
Hidromorava	63%	57%	0.90	122.2	0.5%	8.70	78%	0.15
Bifurkacioni	61%	57%	1.24	32.8	10.3%	6.59	65%	0.10
Mesatarja e sektorit	63%	58%	0.97	41.5	3.6%	6.7	84%	0.11

Tabela 3. Performanca e sektorit në 2008-2009

Kompanitë rajonale të ujësjellësave	Shkalla e arkëtimit (%)	Uji i pafaturuar (%)	Norma e mbulimit të punës	Ankesat e konsumatorëve (nr./1000kon)	Kualiteti i ujit (%)	Efikasiteti i stafit (staf/1000kon)	Konsumi i matur (%)	Kostoja për njësi (€/m ³)
Sektori në 2008	65%	56%	1.04	62.4	3.0%	7.0	86%	0.11
Sektori në 2009	63%	58%	0.97	41.5	3.6%	6.7	84%	0.11
Trendi	negativ	negativ	negativ	pozitiv	negativ	pozitiv	negativ	njejtë

Nga tabela 3 shifet se sektori në përgjithësi ka performuar më dobët në 5 treguesit më të rëndësishëm financiar dhe operativ duke përfshirë shkallën e arkëtimit, ujin e pafaturuar dhe normën e mbulimit të punës, duke e lënë sektorin e shërbimeve të ujit nën nivelin e qëndrueshmërisë financiare. Kualiteti i ujit i cili është një nga treguesit më të rëndësishëm të cilësisë së shërbimit, ka shënuar përqindje më të lartë të dështimeve të mostrave të analizuar. Prej 8 TKP-ve në dy tregues ankesat e konsumatorëve dhe efikasiteti i stafit, trendi ka qenë pozitiv, përderisa vetëm kostoja për njësi të ujit të prodhuar ka mbetur stabil gjatë periudhës 2008-2009.

Tabela 4. Pesha e treguesve

Treguesi	Shkalla e arkëtimit	Uji i pafaturuar	Norma e mbulimit të punës	Ankesat e konsumatorëve	Kualiteti i ujit	Efikasiteti i stafit	Konsumi i matur	Kostoja për njësi	Rritja e numrit të konsumatorëve
Rëndësia	1.0	1.0	1.0	1.0	0.8	0.8	0.8	0.8	0.2

Në përputhje me metodologjinë e aprovuar për vlerësimin e performancës, TKP i është dhënë një rëndësi e cila është ndarë në tri kategori: **(i)** me 1.0 pikë janë peshuar dy tregues më të rëndësishëm financiar, një operativ dhe një i nivelit të shërbimit, **(ii)** me 0.8 pikë janë peshuar tre treguesit operativ dhe një financiar dhe **(iii)** me 0.2 pikë është vlerësuar progresi, në rritjen e numrit të konsumatorëve prej vitit në vit (edhe pse ky nuk është ndonjë tregues i mirëfillt atij i është dhënë një peshë simbolike vetëm për të nxitur kompanitë të bëjnë përpjekje për të regjistruar konsumatorët të ri dhe identifikimin e lidhjeve ilegale), dhe është përdorur vetëm tek vlerësimi i performancës për progresin e arritur gjatë vitit vlerësues 2009 në krahasim me vitin 2008.

Tabela 5. Numri i pikëve sipas treguesve (viti 2009)

Kompanitë rajonale të ujësjellësve	Shkalla e arkëtimit (%)	Uji i pafaturuar (%)	Norma e mbulimit të punës	Ankesat e konsumatorëve(000 Kon)	Kualiteti i ujit (%)	Efikasiteti i stafit (staf/1000kon)	Konsumi i matur (%)	Kostoja për njësi (£/m ³)	Totali i pikëve
Prishtina	0.78	0.67	0.67	0.93	0.68	0.79	0.72	0.09	5.33
Hidroregjioni Jugor	0.51	0.21	0.37	0.50	0.53	0.74	0.64	-0.02	3.48
Hidrodrini	0.52	0.00	0.62	0.66	0.17	0.80	0.80	1.00	4.57
Mitrovica	0.00	0.75	0.00	0.00	0.64	0.00	0.16	0.16	1.71
Radoniqi	1.00	0.62	0.61	0.49	0.79	0.40	0.41	-0.06	4.26
Hidromorava	0.69	0.56	0.39	0.00	0.80	0.28	0.36	0.00	3.08
Bifurkacioni	0.53	0.74	1.00	0.46	0.00	0.64	0.00	0.28	3.65

Totali i pikëve të grumbulluar për një kompani paraqet shumën e pikëve të mbledhura për secilin tregues. Ndarja e pikëve për performancën më të mirë për vitin 2009 si dhe për progresin e arritur në përmirësimin e performancës për periudhën 2008-2009 është bërë në bazë të metodës së njëjtë të përdorur edhe gjatë poentimit të viteve të kaluara, e cila bazohet në ndarjen proporcionale të pikëve varësisht nga niveli i arritur në një tregues. Kështu për kompaninë që ka arritur nivelin më të lartë

në një tregues i është dhënë maximumi 1.0 pikë, përderisa për kompaninë që ka pasur nivelin më të ulët në atë tregues i është ndarë minimumi 0.0, përderisa Kompanitë e tjera kanë marrë proporcionalisht pikë në mes 0.0 dhe 1.0 varësisht prej nivelit të arritur në atë treguesi.

Tabela 6. Numri i pikëve sipas treguesve në përmirësimin e performancës 2008-2009

Kompanitë rajonale të ujësjellësve	Shkalla e arkëtimit (%)	Uji i pafaturuar (%)	Norma e mbulimit të punës	Ankesat e konsumatorëve (000 kons.)	Kualiteti i ujit (%)	Efienca e stafit (staf/1000kon)	Konsumi i matur (%)	Kostoja për njësi (€/m ³)	Rrija e numrit të konsumatorëve (%)	Totali i pikëve
Prishtina	0.67	0.20	0.38	1.00	0.26	0.39	0.57	0.50	0.14	4.11
Hidroregjioni Jugor	0.52	0.00	0.46	0.00	0.63	0.49	0.34	0.14	0.20	2.78
Hidrodrini	0.36	0.69	0.15	0.65	0.45	0.80	0.53	0.08	0.16	3.87
Mitrovica	0.58	0.61	0.00	0.00	0.57	0.00	0.80	0.30	0.11	2.97
Radoniqi	0.59	0.75	0.35	0.46	0.00	0.06	0.21	0.00	0.11	2.53
Hidromorava	0.00	0.22	0.36	0.67	0.80	0.08	0.00	0.63	0.14	2.90
Bifurkacioni	1.00	0.16	1.00	0.00	0.45	0.49	0.57	1.00	0.00	4.67

Tabela 7. Rangimi i kompanive sipas performancës më të mirë në vitin 2009

Pozita	KRU	Pikët e mbledhura
1	Prishtina	5.33
2	Hidrodrini	4.57
3	Radoniqi	4.26
4	Bifurkacioni	3.65
5	Hidroregjioni Jugor	3.48
6	Hidromorava	3.08
7	Mitrovica	1.71

Tabela 8. Rangimi i kompanive sipas përmirësimit të performancës 2008-2009

Pozita	KRU	Pikët e mbledhura
1	Bifurkacioni	4.67
2	Prishtina	4.11
3	Hidrodrini	3.87
4	Mitrovica	2.97
5	Hidromorava	2.90
6	Hidroregjioni Jugor	2.78
7	Radoniqi	2.53

Tabela 9. Rangimi i kompanive gjatë viteve 2006-2009

Kompanitë rajonale të ujësjellësve	Rangimi 2006	Rangimi 2007	Rangimi 2008	Rangimi 2009
Prishtina	3	2	1	1
Hidrodrini	5	6	2	2
Radoniqi	1	1	3	3
Bifurkacioni	7	5	7	4
Hidroregjioni Jugor	4	3	5	5
Hidromorava	2	4	4	6
Mitrovica	6	7	6	7

Kompania Prishtina, ka ruajtur vendin e parë nga viti i kaluar edhe pse ka pasur një trend të lehtë të renies në disa prej treguesve kyç të performancës. Hidrodrini po ashtu ka mbetur stabil gjatë vitit 2008 dhe 2009 pas progresit të arritur gjatë vitit 2008 ndërsa Radoniqi gjatë viteve ka treguar një trend negative dhe nga pozicioni i vendit të parë (vitet 2006 dhe 2007) në vitin 2008 dhe 2009 është ranguar në pozitën e tretë, kjo është shqetsuese për shkak se edhe më tej ka rënie, që vërehet edhe nga rangimi në pozitën e fundit për progresin e arritur gjatë vitit 2008 në vitin 2009.

Bifurkacioni është kompania që ka shënuar progresin më të madhe në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008, duke u ranguar e para. Bifurkacioni është kompania e vetme e cila ka shënuar progres në shumicën e treguesve kyç të performancës për vitin 2009, duke e përforcuar pozicionin e saj në rangimin e performancës për vitin 2009 (e ranguar si e katërta). Tri Kompanitë me performancë më të mirë kanë një diferencë të vogël në pikët totale të tubuara për çka e bënë konkurrencën garuese përmes vlerësimit krahasues më sfidues dhe më nxitës.

5. PERFORMANCA KRAHASUESE E KOMPANIVE RAJONALE TË UJËSJELLËSIT

Për të reflektuar një pasqyrë kuptimplotë për kompanitë publike të shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit (KRU), janë paraqitur të dhëna (në tabela dhe grafe) krahasuese të shoqëruara me analiza tekstuale për 18 tregues, prej të cilëve 9 paraqesin tregues kyç të performancës.

Përshkrimi i treguesve është bërë duke i grupuar në katër kategori:

- Treguesit operativ,
- Treguesit e nivelit të shërbimit,
- Treguesit financiar,
- Treguesit e efikasiteti të stafit.

5.1 Treguesit operativ


5.1.1 Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit

Definicioni: Popullsia me qasje në shërbime të ujësjellësit ndarë për popullsinë e regjistruar në regjionin e mbuluar nga KRU, shprehur në përqindje.

Më shumë se 10 vjet pas përfundimit të luftës popullata e Kosovës ende nuk është mbuluar në tërësi me furnizime me ujësjellës dhe shërbime të kanalizimit nga kompanitë rajonale të ujësjellësve.

Më herët sektori i ujësjellësit është mbështetur nga donatorët ndërkombëtarë ndërsa në vitet e fundit edhe nga niveli lokal me ndihmën edhe të komuniteteve, duke i rritur kështu përpjekjet për të përmirësuar mbulueshmërinë me furnizim të ujësjellësit.

Edhe këtë vit në mungesë të statistikave të sakta të cilat do të dalin nga procesi i regjistrimit të popullsisë në Kosovë, kemi qenë të shtrënguar që të shfrytëzojmë të dhëna nga analizat e realizuara nga Enti i Statistikave të Kosovës (ESK), dhe në mënyrë të tërthortë të vijmë deri te disa të dhëna të vlerësuara në mënyrë që të kemi një perceptim sa më të përafërt për këtë tregues të rëndësishëm. Të dhënat për popullatën janë marrë drejtpërdrejtë nga ky projekt, përderisa të dhënat për popullatën e shërbyer nga KRU, janë fituar me shumëzimin e numrit të faturave të lëshuara për kategorinë e konsumatorëve shtëpiak me koficientin e marrë nga ESK, për numrin e anëtarëve në një ekonomi familjare për regjionet përkatëse.



Grafi 1. Mbulueshmëria me furnizim të ujësjellësit

Në vitin 2009, Radoniqi ka treguar nivelin më të lartë të mbulueshmërisë me ujë me 97% ndërsa Hidromorava nivelin më të ulët me 33%.

Gjatë vitit 2009, krahasuar me vitin 2008 shtrirja e shërbimeve në nivel të sektorit është ngritur për 6%, kjo si rezultat i investimeve nga donacionet ashtu edhe nga mjetet vetanake në zgjerimin e shërbimeve me ujësjellës.

Hidrodrini gjatë vitit 2009 krahasuar me vitin 2008 ka shënuar ngritje për 12% në mbulueshmërinë me shërbime të ujësjellësit⁶, ngritje kjo që ka ndodh për arsye të investimeve në shtrirjen e mbulueshmërisë në disa fshatra.

Investime në zgjerimin e shërbimeve ka pasur edhe nga Kompanitë Prishtina, Bifurkacioni dhe Mitrovica, nga mjetet vetanake por edhe nga donacionet e ndryshme.


⁶ Komuna e Pejës e ka të hartuar, Planin Zhvillimor për Infrastrukturën e Ujësjellësit dhe Kanalizimit -2008

Zgjerimi i mbulueshmërisë me shërbime si një prej aspekteve më të rëndësishme që ndikon në kualitetin e jetës, mirëqënien e popullatës dhe për zhvillimin ekonomik dhe social të tyre është i përcjellur me kosto të lartë e cila veshetirë se mund të përballohet nga KRU-të, prandaj është masë e domosdoshme që Qeveria dhe Komunitat ti drejtojnë investimet e tyre por edhe të donatorëve të mundshëm në drejtim të përmirësimit të gjendjes aktuale.

5.1.2 Mbulueshmëria me kanalizim

Definicioni: Popullsia me çasje në rrjetin e kanalizimit të mirëmbajtur nga kompania ndarë për popullsinë e regjistruar në zonën e shërbimit nga KRU shprehur në përqindje.

Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit nga KRU-të në përgjithësi është më e ultë se sa mbulueshmëria me furnizim të ujit të pijes.



Grafi 2. Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit

Në vitin 2009, nivelin më të lartë të mbulueshmërisë me shërbimet e kanalizimit e ka Radoniqi (63%), ndërsa atë më të ultë Hidromorava (31%).

Gjatë vitit 2009, krahasuar me 2008, shtrirja e shërbimeve me kanalizim në nivel të sektorit ka shënuar rënie për 2%, kjo ka ndodhë për shkak se kompania Prishtina ka eliminuar disa prej konsumatorëve të cilët deri në vitin 2009 janë faturuar edhe me shërbime për kanalizim, edhe pse nuk kanë pas qasje në rrjetin e kanalizimit, ndërsa te kompania Bifurkacioni në këtë trend ka ndikuar ndarja e njësisë operative të Kaçanikut.

Mbulimi i ulët me shërbime të kanalizimit, ofron mundësi potenciale për investime, si në zhvillimin e rrjetit të kanalizimit ashtu edhe të trajtimit të ujërave të zeza, duke e përmirësuar kualitetin e ujit të pijës të konsumuar nga puset.⁷


5.1.3 Prodhimi i ujit

Në vitin 2009, të gjitha kompanitë e ujit së bashku kanë prodhuar në total 133,089,834m³ ujë të pijshëm, kjo do të thotë një rritje për 4,34% krahasuar me vitin 2008. Të gjitha Kompanitë kanë pasur rritje të sasisë së ujit të prodhuar, përjashtuar kompanitë Hidrodrinin dhe Radoniqin të cilat kanë shënuar një zvogëlim të sasisë së ujit të prodhuar. Rritja e prodhimit të ujit në Hidromorave dhe Bifurkacion është për shkak se në këto dy kompani ka pasur rritje të kapaciteteve prodhuese, me nga mbi 1 milion m³ më tepër se sa në vitin paraprak.

⁷ Në zonën e shërbimit të Bifurkacionit dhe në disa vendbanime të zonës së Prishtinës për shkak të reduktimeve të mëdha të ujit, konsumatorët përdorin edhe furnizim alternativ (puse), kualiteti i ujit të tyre në të shumtën e rasteve nuk i plotëson standardet sanitare.

Prodhimi i ujit (l/b/d)

Definicioni: Prodhimi total mujor i ujit i shprehur si litra për ditë për kokë të banorit të furnizuar.



Grafi 3. Prodhimi i ujit (l/b/d)

Sasia e ujit të furnizuar nga KRU-të variron gjerësisht ku sasinë më të lartë për kokë banori në ditë e ka Hidrodrini prej 417 (l/b/d), përderisa sasinë më të vogël e ka siguruar Bifurkacioni me 162 (l/b/d).


Mitrovica është ranguar si e dyta me sasinë e ujit prej 352(l/b/d), megjithatë ajo aplikon reduktime të furnizimit me ujë për shkak se një pjesë të prodhimit të saj, rreth 30% e dërgon në pjesën veriore të Mitrovicës.

Në vitin 2009, kemi një prodhim më të vogël të ujit për kokë banori krahasuar me vitin 2008, përkundër rritjes së përgjithshme të sasisë së ujit të prodhur i cili është si rezultat i një viti me të reshura të bollshme gjë që ka ndikuar që disa kompani mos të kenë kufizime në prodhim. Nga ana tjetër edhe rritja e kapaciteteve prodhuese në

Hidromorav dhe Bifurkacion ka ndikuar në këtë parametër. Mesatarja e prodhimit me ujë në Kosovë për në vitin 2009 është 277(l/b/d).

Prodhimi i ujit ($\text{m}^3/\text{kons}/\text{m}$)

Definicioni: Prodhimi total mujor i ujit i shprehur si m^3 për muaj për konsumatorë të regjistruar.



Grafi 4. Prodhimi i ujit në m^3 për konsumatorë në muaj

Në vitin 2009, Hidrodrini ka patur sasinë më të madhe të ujit të prodhuar $76 \text{ m}^3/\text{kons}/\text{m}$ ndërsa Bifurkacioni sasinë më të ulët të ujit të prodhuar $30 \text{ m}^3/\text{kons}/\text{m}$.


Gjatë vitit 2009 krahasuar me vitin 2008 uji i prodhuar $\text{m}^3/\text{kons}/\text{m}$ në nivel të përgjithshëm ka mbetë i njëjtë me $49 \text{ m}^3/\text{kons}/\text{m}$.

Për çdo rast, këta dy tregues të analizuar (l/b/d) dhe ($\text{m}^3/\text{kons}/\text{m}$) për prodhimin e ujit nuk tregojnë një pasqyrë të qartë për rritjen e sasisë së ujit të prodhuar për arsye se të

dhënat statistikore në të cilat bazohen ende nuk janë mjaft objektiv⁸, megjithatë mund të merren si vlera orientuese.

5.1.4 Shitja e ujit

Definicioni: Shitja totale mujore e ujit e shprehur si m³ për muaj për konsumatorë të regjistruar.



Grafi 5. Shitja e ujit (m³/kons/muaj)

Ky tregues paraqet shitjen e ujit shprehur në m³ për konsumatorë në muaj përfshirë të gjitha kategoritë e konsumatorëve.

Në vitin 2009, Mitrovica⁹ e ka sasinë më të madhe të ujit të faturuar kjo ka ndodhë për arsye që pjesa veriore faturohet si një konsumator i vetëm, ndërsa Bifurkacioni e ka sasinë më të vogël të faturuar.

⁸ Numri i banorve ende është i vlersuar për shkak të mungesës se të dhënave të sakta të cilat do të dilnin nga rexhistrimi i popullsisë

Gjatë vitit 2009, krahasuar me vitin 2008 është konstatuar një rënie e vogël (për 1%) në ujin e faturuar në nivel të sektorit, kjo sasi e ujit të shitur ka mbetur pak a shumë në të njëjtin nivel gjatë këtyre dy viteve.

Në krahasim me vitin 2008 në vitin 2009 Bifurkacioni ka shënuar një ngritje të vogël e cila reflektohet me krijimin e mundësive për një furnizim më cilësor për konsumatorët pas rritjes së kapaciteteve prodhuese gjë e cila nuk është rast tek Hidomorava e cila edhe pas rritjes së kapaciteteve prodhuese ka të njëjten sasi të ujit të faturuar për kons/m.

Hidrodrini rangohet nën mesataren e sektorit me 20 m³ edhe pse ka sasinë prodhuese më të lartë të shitjes për konsumatorë duke vërtetuar se është kompania që ka UPF më të lartë nga të gjitha Kompanitë.

5.1.5 Humbjet e ujit

Humbjet mund të jenë të vërteta (përmese rrjedhjeve të cilat ndonjëher referohen edhe si humbje fizike) dhe humbje administrative (kycjet ilegale, vjedhjet, pasaktësitë gjatë matjes, mbi apo nën vlerësimi i sasisë së llogaritur përmes paushallit, etj), si dhe humbjet nga konsumi i autorizuar por i pa faturuar (krojet publike, në disa raste edhe institucionet fetare).

Niveli i lartë i humbjeve të ujit ka impakt negativ për qëndrueshmërinë financiare të kompanive të ujit i cili ndikon negativisht edhe në cilësinë e ujit të distribuar te konsumtorët.

Vlerësimi i ujit të humbur është një proces kompleks që lidhet me matjen e ujit të prodhuar, matjen e sasisë së ujit me ujëmatës individual, eliminimin e gabimeve të krijuara përmes procesit të faturimit dhe vlerësimit të konsumit përmes paushallit.¹⁰

Arsyet më të shpeshta për dështimin e reduktimit të humbjeve të ujit nga Kompanitë në Kosovë në të shumtën e rasteve mund të përmbledhen si vijon: **(i)** ato ende nuk kanë një qasje strategjike ndaj këtij problemi, **(ii)** në disa kompani kanë një zbatim të pjesëshëm kryesisht në kuadër të disa pilot projekteve, **(iii)** dështime për të mobilizuar burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare si dhe **(iv)** mungesa e identifikimit dhe koordinimit në mes të komponentëve të këtij problemi (identifikimi i humbjeve administrative dhe teknike).

Nga reduktimi i humbjeve të ujit, në veçanti të reduktimit të rrjedhjeve, përfitimet do të ishin të gjithëanëshme për kompanitë dhe konsumatorët, përfshirë në radhë të parë përfitimet financiare nga shitja e ujit të rritur ose duke zvogëluar prodhimin e ujit, zvoglimi i nevojave për shtimin e kapaciteteve prodhuese, përmirësimin e kualitetit të ujit duke reduktuar rrezikun e kontaminimit si dhe përmirësimi i marrëdhënieve me publikun.


⁹ Problemi i pjesës veriore, Mitrovicën e bënë të duket më mirë në këtë tregues se sa është në të vërtet, ngjashëm si tek sasia e ujit të furnizuar për (l/b/d), ku pjesa veriore konsiderohet si një konsumator.

¹⁰ KRU-të nuk aplikojnë ndonjë normë standarde për nivelin e paushallit

Uji i pafaturuar (%)

Definicioni: Uji i pafaturuar paraqet diferencën midis sasisë së uji të prodhuar dhe të ujit faturuar pjesëtuar me ujin e prodhuar, shprehur në përqindje.

Treguesi më i zakonshëm që përdoret për të vlerësuar nivelin e humbjeve të ujit është ai i vlerësuar si përqindje. Përderisa ky tregues është i lehtë për tu kuptuar dhe është duke u përdorur gjerësisht, megjithëse ka qenë gjithnjë i njohur se ky nuk është një tregues më i përshtatshëm për vlerësimin e nivelit të humbjeve të ujit.



Grafi 6. Uji i pafaturuar (%)

Duke ju referuar grafikoni 6 në vitin 2009 krahasuar me vitin 2008, Uji i pa faturuar në mesatare të sektorit kanë shënuar ngritje (trend negativ) prej 56% në 58% çka do të thotë se në 2009, 42% e ujit të prodhuar nuk faturohet.

Humbjet e ujit prej 58% janë të papranueshme kur dihet se kjo është shumë më e lartë se sa niveli i pranueshëm botërisht prej 20%.

Progres në reduktimin e humbjeve të ujit në vitin 2009, ndonëse të lehtë kanë shënuar, Hidrodrini (1%), Mitrovica (3%) dhe Radoniqi (7%). Duket se Radoniqi ka shënuar një përmirësim më të qëndrueshëm në zvogëlimin e UPF si rezultat i zvogëlimit të prodhimit të ujit dhe ngritjes së sasisë së ujit të faturuar në vitin 2009 në raport me vitin 2008.


Për sektorin në tërësi, UPF ishte 58,4% e prodhimit të ujit në 2009, krahasuar me objektivin prej 52'5%. Vetëm Hidrodrini dhe Hidromorava tejkaluan synimet e tyre, edhe pse Hidrodrini sa i përket përqindjes ishte performuesi më i dobët

Hidrodrini ka zhvilluar një qasje më të avancuar ndaj humbjeve të ujit, duke reaguar në nivelin aktual të lartë të humbjeve të ujit. Në këtë kontekst ajo ka themeluar departamentin për humbje të ujit, ka vendosur ujëmatës për matjen e ujit të prodhuar dhe të distribuar si dhe ka zhvilluar istemin informativ gjeografik (GIS), të cilat aktivitete duhet që në një të ardhme të afërt të japin rezultate të pritura.

ZRRUM-i, pret nga KRU e tjera që të ndjekin shembullin e Hidrodrinit dhe të zhvillojnë qasje të avancuar në adresimin e nivelit të lartë të UPF

Uji i pafaturuar ($\text{m}^3/\text{kons}/\text{muaj}$)

Definicioni: Sasia e ujit të humbur për konsumatorë në muaj.



Grafi 7. Humbjet e ujit në $\text{m}^3/\text{kons}/\text{m}$

Edhe tek ky tregues në vitin 2009 krahasuar me vitin 2008 shifet se Uji i pafaturuar kanë shënuar trend negativ në mesataren e sektorit nga $27(\text{m}^3/\text{kon}/\text{muaj})$ në $28(\text{m}^3/\text{kon}/\text{muaj})$.

Kompanitë si Hidrodrini, Radoniqi dhe Mitrovica kanë trende pozitive në këtë tregues ashtu sikurse që u pa edhe tek treguesi i Ujit të Pafaturuar i llogaritur në përqindje.

Ky tregues si në shkallë vendi ashtu edhe te secila nga kompanitë veç e veç është si mesatare e shumëfishtë krahasuar me ofruesit e shërbimeve tek vendet e zhvilluara Evropiane si p.sh Gjermania apo Britania e Madhe (me 10-20% humbje vjetore të ujit).

Një mënyrë alternative e vlerësimit të performancës së UPF është që të shqyrtojë humbjet absolute të ujit për konsumatorë për muaj. Mbi këtë bazë performanca e sektorit prej 28 m³/kons/m ka tejkaluar për pak objektivin e saj prej 29 m³/kons/m Prishtina, Hidrodrini, Radoniqi dhe Hidromorava kanë tejkaluan objektivin poashtu.

Ujit i pafaturuar në të ardhmen do të shqyrtohen edhe nga aspekti i humbjeve të ujit për km të rrjetit brenda ditës (m³/km/d/h), pasi të sigurohemi që kemi të dhëna të sakta nga Kompanitë.

Nëse humbjet e larta të ujit paraqiten në terme monetare, siç tregohet në tabelen 10, mundemi më lehtë të kuptojmë madhësinë e problemit dhe shumën e të hyrave të humbura. Kjo duhet të shërbejë si një nxitje për secilën kompani për të dalë me një strategji për reduktimin e humbjeve të ujit.

Tabela 10. Të dhënat për ujin e pa faturuar (UPF)

Kompanitë rajonale të ujësjellësve	UPF (%)	UPF (milion m3)	UPF (milion €)
Prishtina	54%	24,35	3.41
Hidroregjioni Jugor	55%	8,36	1.00
Hidrodrini	74%	20,87	1.04
Mitrovica	51%	8,82	0.88
Radoniqi	55%	8,36	1.00
Hidromorava	57%	3,93	0.59
Bifurkacioni	57%	2,91	0.29
Totali	58%	77.1	8.2

5.1.6 Shkalla e konsumit të matur

Uji i matur është proces i matjes së konsumit të ujit përmes matësve të ujit, ndërsa qëllimi kryesor i vendosjes së ujëmatësve të konsumatorëve është faturimi i sasisë së shpenzuar të ujit duke u bazuar në konsumin e matur.


Konsumi i matur individual i konsumatorëve duhet të jetë një komponentë integrale e furnizimit me ujë të kompanive në vend për shkak se konsumatorit i jepet mundësia që ai të ndikojë në ngarkesën e faturës së vetë, mandej po ashtu edhe kërkesave gjithnjë në rritje për menaxhimin e ujit si dhe për vlersimin real të humbjeve të ujit.

Në mungesë të ujëmatësve individual konsumatorët nuk kanë ndonjë stimulim për të kufizuar konsumin e ujit përderisa ai nuk matet dhe nuk faturohet në bazë të konsumit të matur kjo qon në harxhimin e sasive të ujit mbi mesataren, sidomos gjatë muajve të verës ku përdorimi i ujit bëhet edhe për ujitjen e kopshteve, duke e rritur konsumin dhe duke krijuar vështirësi edhe në funksionimin e sistemit të ujësjellësit.

Niveli i ultë i matjes së ujit është faktor kryesor që kontribon në rritjen e humbjeve të ujit dhe përderisa nuk kemi konsum të matur deri në 100%, humbjet e llogaritura të ujit janë ende vetëm vlerësime.

Konsumi i matur në (%)

Definicioni: Vëllimi i ujit të faturuar në baze të matjes, ndarë për vëllimin total (paushall plus sasinë e matur) të ujit të faturuar, shprehur në përqindëje



Grafi 8. Konsumi i matur


Konsumi i matur në vitin 2009 krahasuar me vitin 2008 në nivel të sektorit ka shënuar rënie për 2%, kjo për arsye të rënies së konsumit të matur në disa nga kompanitë siç janë Hidromorava, Radoniqi dhe Hidroregjioni Jugor.

Zvogëlimi i konsumimit të matur mund të paraqes vlerësim më real të gjendjes aktuale sesa shtrembërim të saj. Supozohet se ky rezultat është për shkak të mungesës së matjes ë konsumit (të përafërt) në të kaluarën i cili tashmë matet më saktë pasi instalimit të ujëmatësve të rinj.

Gjatë vitit 2009 krahasuar me atë 2008, Hidrodrini ka shënuar përqindjen më të lartë të konsumit të matur me 93%, pastaj rangohet Prishtina me 90%.

Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)

Definicioni: Konsumatorët me ujëmatës ndarë për konsumatorët e regjistruar, shprehur në përqindje.



Grafi 9. Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%),

Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës në nivel të sektorit ka rënë prej 80% në vitin 2008 në 79% në vitin 2009.

Edhe në vitin 2009, Radoniqi ka përqindjen më të lartë të konsumatorëve me ujëmatës prej 94% kurse Mitrovica me nivelin më të ultë prej 51%.

Ujëmatësi funksional është një parakusht për faturimin real të konsumatorëve në bazë të konsumit real të tyre.

Gjatë inspektimit të leximit të ujëmatësve individual të ndërmarrë nga ZRRUM-i, në disa nga zonat e shërbimit të KRU-ve (Prishtina, Bifurkacioni, Hidromorava dhe Mitrovica) është konstatuar se një numër i tyre janë jo funksional dhe të pa

mirëmbajtur rregullisht. KRU-të nuk kanë mundur të sigurojnë ndonjë standard që do të aplikohet për ujëmatësit si p.sh. saktësia, qëndrueshmëria, etj.

Problemet lidhur me ujëmatësit lindin veçanërisht në rastin e furnizimit me ndërprerje si dhe ndryshimeve të papritura në presion të cilat mund ti dëmtojnë ujëmatësit duke i bërë jo funksional, dukuri e cila është e zakonshme në disa kompani. Gjithashtu ujëmatësit bëhen gjithnjë e më pak të saktë me kalimin e kohës, nëse nuk mirëmbahen, riparohen dhe zëvendësohen rregullisht gjatë përdorimit të tyre.

ZRRUM-i kërkon që KRU-të në të ardhmen të instalojnë ujëmatësia të përcaktuar me standarde të pranueshme ndërkombëtarisht, të cilat kanë saktësinë e duhur, të bëhet kalibrimi i tyre i rregullt dhe gjithashtu kërkohet që tek banesat kolektive të vendosen ujëmatës individual për secilin konsumatorë.

5.2 Treguesit e nivelit të shërbimit

5.2.1 Kualiteti i ujit

Kualiteti i ujit të pijshëm është njëri prej treguesve kryesor të kualitetit të shërbimit i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon në shëndetin e njeriut. Kompanitë publike janë përgjegjëse për të furnizuar ujë të pijshëm cilësorë, përderisa kualiteti i ujit të pijshëm në Kosovë monitorohet nga IKSHPK i cili është institucion përgjegjës në bazë të udhëzimit administrativ 2/1999 për përcaktimin dhe mbikqyrjen e standardeve të cilat duhet ti plotësojë uji për pije.

Ne jemi të kënaqur që përmes këtij raporti vjetor ti informojmë konsumatorët dhe publikun e gjerë për cilësinë e ujit të pijes të cilin e konsumojnë ndërsa përkushtimi dhe qëllimi i vazhdueshëm i ZRRUM-it është që të sigurojë se Kompanitë e rregulluara ofrojnë furnizim të sigurt dhe të besueshëm të ujit të pijshëm për qytetarët në Kosovë. Rreth 66% e popullatës së përgjithëshme në Kosovë furnizohet me ujë të pijshëm nga Kompanitë publike dhe pjesa tjetër kryesisht furnizohet me ujë nga pusët individuale. Pjesa urbane kryesisht është mbuluar me furnizim qëndror, në disa qytet ku reduktimet e ujit janë të shprehura, furnizimi bëhet në menyrë alternative edhe nga ujësjellësi por edhe nga pusët individuale sidomos në Ferizaj, Fushë Kosovë, Shtime, etj. ndërsa pjesa rurale ende nuk është e mbuluar në tërësi me furnizimi nga sistemi qëndror.

Shumica e ujit të përdorur për pije (qofshin ato burime sipërfaqësore apo nëntoksore) kërkon disa lloje të trajtimit para se të përdoret për pije ndërsa shkalla e trajtimit varet nga lloji dhe niveli i ndotjes.

Tabela 11. Analizat e kualitetit të ujit të pijshëm në vitin 2009

Kompanitë rajonale të ujësjellësve	Analiza Bakterologjike		Analiza Fiziko-kimike	
	Të analizuara	Jashtë standardeve	Të analizuara	Jashtë standardeve
Prishtina	3,881	93	710	-
Hidroregjioni Jugor	1,235	45	498	22
Hidrodrini	1,273	85	480	60
Mitrovica	1,181	19	412	20
Radoniqi	867	6	498	3
Hidromorava	701	5	307	-
Bifurkacioni	709	58	386	55
Totali	9,847	311	3,291	160

Parametrat e cilësisë së ujit të pijshëm zakonisht ndahen në dy kategori: Kimiko/Fiziko dhe Mikrobiologjike. Parametrat kimik kanë tendencë të parqesin rrezik në aspektin kronik, parametrat fizik ndikojnë në estetikën dhe në shijen e ujit të pijes, përderisa parametrat mikrobiologjik (sidomos ata patogjenë) janë me interes më të madhë për shkak të rrezikut të menjëhershëm të tyre në shëndetin e njeriut.


Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 2/1999, është paraparë frekvenca dhe numri i mostrave të cilat merren për testime laboratorike si nga uji i papërpunuar ashtu edhe nga uji i përpunuar. Shumica e mostrave tek uji i përpunuar merren nga qeshmet e konsumit të rrjetit shpërndarës dhe çdo mostër mund të testohet për disa parametra të caktuar.

Rezultatet e cilësisë së ujit të pijshëm të raportuara nga IKSHPK për vitin 2009 tregojnë se nga 9,847 mostra nga rrjeti shpërndarës, 311 apo 3.16% janë jashtë standardit nga pikëpamja bakterologjike, përderisa nga 3,291 të mostrave të marra për testime kimiko-fizike, 160 apo (4,86%) nuk i plotësojnë standardet e përcaktuara.

Ashtu si edhe viteve të mëparshme më shumë mostra jashtë standardeve i përkasin parametrave kimiko-fizike e më pak nga aspekti mikrobiologjik.

Dështimi i kualitetit të ujit (%)

Definicion: Numri total i mostrave të analizuara të ujit të trajtuar që nuk janë në pajtim me standardet ndarë për numrin total të mostrave të analizuara për ujin i trajtuar, shprehur në përqindëje



Graf. 10 Dështimi i kualitetit të ujit (%)


Në vitin 2009 krahasuar me vitin 2008, kualiteti i ujit në nivel mesatar të sektorit ka shënuar trend negativ nga 3.0% në 3.6%, duke shënuar ngritje prej 0.6% të mostrave të cilat nuk janë në përputhje me standardet.

Gjatë vitit 2009 Hidromorava ka bërë një përmirësim të konsiderueshëm në krahasim me vitin 2008 duke ofruar ujë të cilësisë së lartë me vetëm 0.5% të mostrave të dështuara dhe e cila është ranguar në vendin e parë si kompania më e mirë sa i përket cilësisë dhe kualitetit të ujit të ofruar.

Performancën më të dobët për vitin 2009 e ka Bifurkacioni me 10,3% pasuar nga Hidrodrini me 8,3% të mostrave jashtë standardeve për vitin 2009 ndërsa në përgjithësi në katër nga shtatë KRU-të (Bifurkacionin, Hidrodrinin, Prishtinën dhe Radoniqin) ka pasur trende negative në kualitetin e ujit.

5.2.2 Furnizimi pa ndërprerje

Definicioni: Mesatarja e furnizimit të ujit në ditë që i ofrohet konsumatorëve në zonën e shërbimit shprehur në orë.



Grafi 11. Orët e furnizimit

Furnizimi i rregullt me ujë dhe pa ndërprerje është poashtu tregues mjaft rëndësishëm i kualitetit të shërbimit.

Në zonën e shërbimit të dy kompanive sikurse janë: Prishtina¹¹ dhe Mitrovica brengosëse janë ndërprerjet e ujit në intervale të gjata kohore dhe pa ndonjë ndarje proporcionale.


Nga diagrami shifet se prej shtatë kompanive vetëm katër prej tyre kanë mundësi ti furnizojnë konsumatorët 24 orë me ujë të pijës përveç nëse ndodhë ndonjë defekt i madhë teknik siç ishte ai në Gjakovë gjatë verës së vitit 2009.

¹¹ Prishtina nuk kanë ofruar të dhena në ZRRUM, për reduktimet e ujit për vitin 2008 dhe 2009

Në tërësi, orët e furnizimit me ujë të pijshëm janë përmirësuar në Hidromoravë dhe në Bifurkacion.

5.2.3 Ankesat e konsumatorëve

Definicioni: Numri i ankesave ndaj shërbimeve ndarë për '000 konsumatorë të regjistruar.



Grafi 12. Ankesat për (1000 konsumatorë)

Numri i ankesave për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza për 1000 konsumatorë është zvogëluar në vitin 2009 me 41,5 prej 62,4 ankesa sa ishin në vitin 2008.

Hidromorava ka regjistruar numrin më të madh të ankesave për vitin 2009 me 122,2 ankesa për një mijë konsumatorë, Mitrovica nuk ka të raportuar asnjë ankesë përderisa Hidroregjioni Jugor dhe Bifurkacioni në vitin 2009 i kanë trajtuar më me përkushtim ankesat dhe kanë mbajtur një regjistër më të mirë të tyre.

Me sa duket zvogëlimi i ankesave drejtuar kompanive mund të jetë ende për shkak të të metave të procedurave të regjistrimit të ankesave apo edhe nga fakti se

konsumatorët janë mësuar me shërbime të dobëta dhe kanë vërejtur se nuk ka dobi për adresimin e ankesave tek Kompania.

Standardet e pararpara për zgjedhjen e ankesave të konsumatorëve sipas rregullave të ZRRUM-it, parashohin që në ankesa teknike të reagohej brenda 6 orëve nga njoftimi përderisa në ankesa komerciale kompania duhet të përgjigjet brenda 14 ditëve me shkrim që nga parashtrimi i ankesës.

Është parë se kalimi i kohës së gjatë për konsumatorin në prashtrimin dhe adresimin e një ankese tek Kompanitë dhe po ashtu zgjedhja e saj e tej zgjatur ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në humbjen e kredibilitetit të kompanisë tek konsumatori por edhe në dobësimin e llogaridhënies së konsumatorit për ofruesin e shërbimit.

Tabela 12. Ankesat e konsumatorëve


Kompanitë rajonale të ujësjellësve	Ankesa teknike		Ankesa komerciale-industriale		Total ankesa	
	2008	2009	2008	2009	2008	2009
Prishtina	4,833	1,494	3,126	1,273	7,959	2,767
Hidroregjioni Jugor	-	622	-	163	-	785
Hidrodrini	1,760	1,691	67	106	1,827	1,797
Mitrovica	-	-	-	-	-	-
Radoniqi	1,140	1,112	490	500	1,630	1,612
Hidromorava	2,172	2,023	34	15	2,206	2,038
Bifurkacioni	-	258	-	200	-	458
Total	9,905	7,200	3,717	2,257	13,622	9,457

5.3 Treguesit financiarë

5.3.1 Efikasiteti i arkëtimit

Definicioni: Shuma në Euro e të hyrave operative të arkëtuara (pa TVSH), pjesëtuar me shumën e të hyrave operative të faturuar, në Euro, për periudhën e caktuar (pa TVSH).

Faturimi efektiv dhe sistemi i arkëtimit janë komponente kritike për sigurimin e realizueshmërisë financiare të nevojshme për ofruesit e shërbimeve. Përmirësimi i tyre ka një ndikim të menjëhershëm në rrjedhjen e të ardhurave e që si rezultat përfundimtar ndihmon përmirësimin e shërbimeve nga ana e ofruesit të Shërbimit. Megjithatë një sistem i fuqishëm i faturimit dhe arkëtimit varet edhe nga shumë faktorë të brendshëm duke përfshirë azhurimin e bazës së të dhënave të konsumatorëve dhe hartimin e procedurave të faturimit, ngritjen e shkallës së ujit të matur, redukimi i faturimit paushall, shpërndarja e faturave dhe çasja në objektet për pagesat e konsumatorëve, si dhe nxitja dhe inkurajimi i stafit për të bërë leximin dhe arkëtimin e faturave më me zell.



Grafi 13. Shkalla e arkëtimit (%)

Në vitin 2009 shkalla aktuale e arkëtimit për faturat e ujit dhe ujërave të zeza si mesatare e sektorit është 63% e cila shënon një rënie nga viti 2008 për 2%.

Shkallën më të lartë të arkëtimit për vitin 2009 e ka shënuar Radoniqi megjithatë krahasuar me vitin 2008 ka shënuar rënie për 2%, ndërsa shkallën më të ultë e ka Mitrovica me 51%. Përveç Bifurkacionit e cila në vitin 2009 ka pasur një rritje të shkallës së arkëtimit prej 4% të gjitha kompanitë tjera kanë shënuar trend negativ në këtë tregues.

Të gjitha KRU kanë dështuar në përmbushjen e objektivit të përcatuar në vitin 2009 për shumën e Faturimit, ndërsa sektori ka arritur vetëm 83% të objektivit. Kështu vetëm Hidroregjioni Jugor ka arritur objektivin e tij të arkëtimit (në terma absolute, Euro), dhe ka tejkaluar objektivin e tij për 1%. Në përgjithësi, arkëtimi ka arritur vetëm 76.4% të objektivit, duke përfaqësuar 62.7% të faturimit në vend të 69.7%.


Shkalla e arkëtimit mund të ngritet në mënyrë të ndjeshme nëse kompanitë i marrin disa masa të brendshme organizative duke filluar nga krijimi i një faturimi efektiv e deri tek nxitja e konsumatorëve për të paguar përmes, riprogramimit të borxheve, zbatimit të procedurave ligjore (paditja me kohë në gjykata), masave teknike (zbatimi i ndërprerjeve respektivisht shkyçjeve të furnizimit me ujë, redukimet e presionit të ujit, vendosja e shërbimeve me parapagim përmes kartave të parapaguara, etj).

5.3.2 Shpenzimet operative për njësi(€/m³)

Definicioni: Kostoja operative për prodhimin e një m³ ujë të trajtuar

Ky tregues në masë të madhe ndikohet nga disa faktorë të brendshëm të kompanisë, sikurse janë, disponimi me burime të ujit, lloji i sistemit të përdorur për furnizim me ujë, shkalla e trajtimit të ujit, etj.

Në parim, kompanitë më të mëdha do të duhet të ishin në gjendje të sigurojnë shfrytëzim më racional të kapaciteteve prodhuese dhe të personelit dhe si rrjedhim kostoja për njësi të prodhimit (1m³ ujë) për kompanitë e mëdha do të duhej të ishte më e ulët se te kompanitë e vogla. Ky parim ka qenë në favor të rajonalizimit të kompanive në Kosovë, duke krijuar kompani më të mëdha të cilat do të kishin dobi nga shfrytëzimi i ekonomis së shkallës.



Grafi 14. Kostoja e prodhimit të ujit


Kostoja njësi për prodhimin e një m³ ujë, për mesatarën e sektorit me 0.11 për 2009 ka mbetur e njëjtë me atë të vitit 2008.

Bifurkacioni dhe Hidromorava, gjatë periudhës raportues kanë pasur një zvogëlim të ndjeshëm të shpenzimeve për njësi prodhimi me 0.08€ (Bifurkacioni), përkatësisht me 0.03€ (Hidromorava). Ky zvogëlim i shpenzimeve në këto dy kompani vjen për arsye të rritjes së kapaciteteve prodhuese dhe ndryshimeve të vogëla në disa kategori të shpenzimeve Operative.

Hidrodrini në këtë treguese është në avantazh në raport me kompanitë e tjera me çmim më të ulët për njësi prodhimi, për shkak se një përqindje të madhe të sistemit të furnizimit me ujë e ka me gravitet.

5.3.3 Struktura e shpenzimeve operative

Definicioni: Ndarja e shpenzimeve operative sipas kategorive në raport me shpenzimet totale.



Grafi 15. Shpenzimet operative sipas strukturës

Përqindjen më të lartë (mbi 50%) në strukturën e shpenzimeve operataive tek kompanitë e ujit e përbëjnë shpenzimet për stafin.


Radoniqi dhe Bifurkacioni kanë shpenzimet më të larta për staf të cilat për vitin 2009 janë 72% (Radoniqi) dhe 73% (Bifurkacioni).

Proportcionin e dytë më të lartë të shpenzimeve e përbëjnë shpenzimet e energjisë, në mesataren e sektorit për vitin 2009, ato ishin 22% dhe janë më të larta se sa në vitin 2008 me 3%, vetëm dy kompani Prishtina dhe Mitrovica kanë shpenzime për ujin e blerë me shumicë, vlen të potencohet se Bifurkacioni edhe përkundër shpenzimeve në kemikale me 5.8%, kualitetin e ujit e ka ende me përqindje të lartë të dështimeve.

5.3.4 Norma e mbulimi të punës

Definicioni: Të hyrat operative të arkëtuara ndarë për shpenzimet operative pa amortizim.

Norma e mbulimit të punës paraqet shpenzimet operative vjetore në raport me arkëtimin dhe njëherit është tregues i cili më së miri e pasqyron gjendjen financiare të kompanisë.



Grafi 16. Norma e mbulimit të punës

Shkalla e mbulimit të shpenzimeve operative prej të hyrave nga faturimi për shërbimet e ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza variron nga një ndërmarrje në tjetrën.

Nga grafi 15, shifet se norma e mbulimit të punës në pesë nga shtatë kompanitë ka shënuar trend negativ, përveç Bifurkacionit dhe Hidroregjionit Jugor të cilët kanë treguar përmirësim në këtë tregues.

.

Kompania, Bifurkacioni ka pasur një ngritje të mirë në shkallën e arkëtimit dhe zvogëlim të shpenzimeve operative e cila ka ndikuar në normën e punës që të ketë përmirësim të ndjeshëm.

Norma e mbulimit të punës lidhet me të ardhurat operative dhe koston operative totale. Sektori ka arritur 0.97, krahasuar me një objektiv 1.21, dhe në mënyrë të qartë kjo është e paqëndrueshme. Katër prej shtatë kompanive kanë arritur të mbulojnë shpenzimet operative me të hyrat e tyre operative.

Norma e punës në përgjithësi është zvogëluar në 0.97 për vitin 2009 nga 1.04 sa ishte në vitin 2008.

Niveli aktual i të hyrave nga faturat për shërbimet e ujit dhe të kanalizimit ju mundëson vetëm katër kompanive rajonale që të mbulojnë kostot e tyre operative (personelin, energjinë, kemikalet, derivatet dhe shpenzimet e tjera operative) si dhe një pjesë të vogël të mirëmbajtjes, përderisa shpenzimet për investime kapitale janë të limituara. Tri kompanitë e tjera si, Hidromirava, Hidroregjioni Jugor dhe Mitrovica, janë nën nivelin e mbulimit të shpenzimeve operative. Këto kompani duhet të kenë si synim arritjen e normës prej 1.00, në mënyrë që shpenzimet operative ti mbulojnë me të hyrat që ato i gjenerojnë.


5.3.5 Norma e punës

Definicion: Të ardhurat operative nga faturat e lëshuara dhe nga të ardhurat tjera operative ndarë për shpenzimet operative pa amortizim.

Norma e punës, është një tregues që ilustron gjendjen financiare të kompanisë e cila do të duhej të ishte nëse kompania do të arrij të mbledhë gjithë shumën e faturuar dhe njëkohësisht paraqet mundësinë e kompanisë për mbulimin e shpenzimeve operative pa amortizim me të hyrat nga faturimi dhe të hyrat e tjera operative.

Norma e punës në nivel të sektorit në përgjithësi është 1.53 dhe gjatë periudhës dy vjeçare (2008-2009) ka mbetur e pandryshuar.

Normën e punës më të lartë e ka Bifurkacioni me 1.94 për vitin 2009 dhe ka shënuar një rritje prej 0.50, ndërsa Mitrovica rangohet e fundit me normë të punës prej 1.24.



Grafi 17. Norma e punës

Norma e punës lidhet me të hyrat operative të faturuara dhe koston operative totale. Sektori ka arritur 1.53, krahasuar me një objektiv prej 1.72 kështu çdo KRU ishte më poshtë se objektivi. Shpenzimet ishin pak më poshtë objektivit, pavarësisht nga ngarkesat e larta për energji, por faturimi, siç u përmend më lart, ishte zhgënjyes.


Vlenë të përmendet se rritja e shpenzimeve operative, rënia e shkallës së arkëtimit dhe zvogëlimi i të hyrave të tjera operative te disa kompani, ka ndikuar që të kenë normën e punës më të ulët në vitin 2009.

5.4 Treguesi i Efikasitetit të stafit

5.4.1 Stafi për 1'000 konsumatorë

Definicioni: Numri total i stafit në raport me njëmijë pika faturuese.

Një tregues i rëndësishëm për të llogaritur kërkesat për staf apo për të redukuar fuqinë punëtore të tepërt është numri i stafit që duhet të shërbejnë për 1000 lidhje apo kyçje. Ngarkesa me staf të tepërt qonë në rendiment të ulët të punës së tyre dhe sigurisht që në instancën e fundit rritë koston financiare të fuqisë punëtore. Forcimi dhe mirëmenaxhimi i burimeve njerëzore është një nga sfidat me të cilën duhet të përballen Kompanitë në Kosovë për të përmirësuar eficiencën e punës dhe për të rritur standardet e shërbimeve.



Grafi 18. Stafi (1000 konsumatorë)

Të gjitha kompanitë publike në Kosovë kanë të punësuar më shumë staf se sa që është e nevojshme. Norma për staf në nivel të sektorit ka qenë 6.7 të punësuar/për

1000 konsumatorë për vitin 2009 duke treguar një trend të përmirësimit nga viti 2008 për 0.3 të punësuar.

Në krahasim me vendet e zhvilluara të Europës ku ky tregues sillet 4-7 punëtorë/1000 lidhje mund të themi se ende është i lartë.

Për vitin 2009 Mitrovica e ka numrin më të lartë të punëtorëve që shërbejnë për njëmijë konsumatorë me 10,27 përderisa Hidrodrini me 5.70 e ka efikasitetin më të lartë të punëtorëve për njëmijë lidhje.

Menaxhmenti i KRU-ve duhet të ketë një çasje reformuese sa i përket menaxhimit me burime njerëzore, fillimisht me analizimin e fuqisë punëtore ekzistuese dhe ristrukturimin e mundshëm të fuqisë punëtore e më pas edhe sa i përket ngritjes së strukturës kualifikuese të tyre, trajnimeve të nevojshme si dhe motivimin e stafit.

6. PËRGJEGJËSHMËRIA E KRU-ve NDAJ ZRRUM-it

ZRRUM-i edhe gjatë vitit 2009 ka vazhduar të monitorojë performancën e KRU-ve në lidhje me përgjegjëshmërinë e tyre ndaj procesit rregullator ndërsa për vlerësimin e këtij treguesi janë marrë parasysh këto kritere:

- Respektimi i afateve kohore për raportim sipas ROFK,
- Koha e dorëzimit dhe kualiteti i aplikacionit për tarifa,
- Pagesa e taksës vjetore të licencimit,
- Përgjigjja në kërkesat dhe obligimet e tjera ndaj ZRRUM-it.

Pozita	KRU	Piket Totale 2008	Piket Totale 2009
1	Hidrodrini	1.67	3.17
2	Prishtina	2.67	3.00
3	Radoniqi	3.00	2.17
4	Bifurkacioni	3.17	2.00
5	Hidroregjioni Jugor	1.50	2.00
6	Mitrovica	0.83	1.67
7	Hidromorava	1.33	0.83

Rangimi i kompanive sa i përket këtij treguesi është bërë sipas metodologjisë së njëte e cila është përdorur edhe tek ndarja e pikëve në lidhje me TKP.

Këtë vit (2009), kompania më e përgjegjshme ndaj ZRRUM-it është Hidrodrini me 3.17 pikë të mbledhura nga 4 sa ishte maximumi i mundshëm. Hidrodrini ka shënuar përmirësim të ndjeshëm prej vitit të kalur në këtë tregues, ndërsa Hidromorava është treguar kompania më pakë e përgjegjshme në raport me të gjitha kompanitë e tjera. Gjithashtu po e njëjta kompani krahasuar me vitin 2008 ka qenë edhe më pak përgjegjshme ndaj ZRRUM-it.

Tri kompanitë me performancë të përgjithshme më të mirë po ashtu kanë performacë të mirë edhe në këtë tregues, duke qenë më të përgjegjshme ndaj proceseve rregullatore në krahasim me kompanitë e tjera.

Kompanitë e rregulluara, duhet të kenë të kurtë se për të pasur efekte pozitive sa më të mëdha dhe të qëndrueshme nga proceset rregullatore të udhëhequra nga ZRRUM-i ato duhet ta ngrisin ndjeshmërinë dhe përgjegjëshmërinë e tyre, duke u përgjigjur kërkesave rregullatore si në cilësi ashtu edhe në kohë.

7. INVESTIMET KAPITALE

Tabela 13. Realizimi i investimeve 2009

KRU	Shuma totale e investimeve (€)	Ne shërbimet e ujësjellësit (€)	Ne shërbime e kanalizimit (€)	Nga mjetet vetanake (€)	Nga donatoret(€)
Prishtina	987,304	906,520	80,783	696,904	290,399
Hidroregjioni Jugor	323,851	313,351	10,500	94,524	225,327
Hidrodrini	167,090	166,340	750	133,273	33,810
Mitrovica	445,975	402,127	43,848	0.,000	445,970
Radoniqi	239,043	239,043	0.000	12,319	226,723
Hidromorava	172,211	112,711	59,500	3174	169,036
Bifurkacioni	876,827	563,047	313,779	40,886	835,940
Totali	3,212,301	2,703,139	509,160	981,080	2,227,205

Në tabelen 13 është dhënë një pasqyrë e investimeve kapitale të realizuara nga kompanitë e ujit gjatë vitit 2009. Vlera e investimeve totale në shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizim për vitin 2009 është 3,212,301€, prej të cilave 2,703,139€ janë investuar në shërbime të ujësjellësit ndërsa pjesa tjetër 509,160€ në shërbime të kanalizimit. Nga totali i mjeteve të investuara pjesa e mjeteve prej 2,227,205€ apo 69% kanë qenë donacione, përderisa pjesa tjetër 981,080€ apo 31% janë siguru nga burimet vetanake të kompanive. Shumica e investimeve tek ujësjellësi 1,676,892€, janë bërë në pjesët e infrastrukturës së ujësjellësit të cilat krejsisht kanë të bëjnë me rehabilitimin e tubacioneve, zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit si në zona urbane ashtu edhe ato rurale, sidomos në zonën e shërbimit të Bifurkacionit, Prishtinës dhe të Hidrodrinit. Investime ka pasur edhe në vendosjen e ujëmatësve individual dhe zonal, blerjen e pajisjeve për menaxhimin e humbjeve të ujit, pompave dhe pajisjeve të tjera. Me 1,026,191€ janë mbuluar edhe pjesët jo infrastrukturore sikurse janë, rehabilitimi i ndërtesave dhe zyreve, blerja e automjeteve, pajisje të teknologjisë informative, etj. ndërsa nuk ka pasur investime në lidhje me zgjerimin e kapacitetit të prodhimit të cilat janë mase të domosdoshme në Prishtin dhe Mitrovicë

8. PERFORMANCA E FURNIZUESIT TË UJIT ME SHUMICË

Ibër Lepenci është një kompani hidroekonomike e cila aktivitet kryesor ka shfrytëzimin e ujit si dhe furnizimin me ujë me shumicë të papërpunuar për shfrytëzues të ndryshëm, në nevojë të ujitjes, industrisë si dhe të ujësjellësve.

Monitorimi i performancës dhe vlerësimit krahasues për Ibër Lepencin si ndërmarrje e veçantë nga kompanitë të cilat bëjnë furnizim me ujë të pijshëm, është nën mandatin rregullator të ZRRUM-it vetëm në pjesën që ka të bëjë me furnizim me ujë të patrajtuar me shumicë për dy kompanitë rajonale, Mitrovicën dhe Prishtinën. Mitrovica furnizohet me ujë të pa përpunuar në sasinë prej rreth 500 l/s përderisa Prishtina me sasinë prej rreth 40 l/s për njësinë operative të Drenasit.

Performanca e Ibër Lepencit vlerësohet me një numër të kufizuar të treguesve financiarë të paraqitur në tabelën 14.

Parametrat të cilët ndikojnë në shpenzimet operative (në pamundësi të ndarjese prej pjesës tjetër të operimit), janë marrë në bazë të një çelësi të përvetësuar nga kompania IL dhe ZRRUM.

Tabela 14. Performanca e NPH Ibër Lepenci

Treguesi i performancës	2007	2008	2009	Trendi
Shkalla e arkëtimit	15%	114%	82%	negativ
Norma e punës	1.4	1.4	0.84	negativ
Norma e mbulimit të punës	0.2	1.54	0.69	negativ
Kostoja e operimit për njësi (€/m ³)	0.013	0.013	0.021	negativ

Performanca e Ibër Lepencit në vitin 2009 pas një progresi të mirë të arritur në vitin 2008 ka shënuar një trend në ulje të gjithë treguesit e punës.

Shkalla e arkëtimit prej 82% gjatë vitit 2009 është më e ulët se ajo e vitit 2008 ku kjo shkallë ishte 114%. Norma e punës po ashtu ka rënë nga 1.4 sa ishte në vitin 2008 në 0.84 gjatë vitit 2009. Dy treguesit financiar, norma e mbulimit të punës dhe norma e punës janë të ndikuar nga efikasiteti i ulët i arkëtimit si dhe nga rritja e shpenzimeve operative.

Niveli i ulët i normës së punës tregon se Ibër Lepenci nuk ka qenë në gjendje që të mbulon shpenzimet operative me të hyrat e realizuara.

9. KOMENTET DHE REKOMANDIMET PËR KOMPANITË E UJIT

KRU “Prishtina” Sh.a

- Të ngriten kapacitetet prodhuese për të mundësuar furnizimin e pa ndërprerë me ujë për të gjithë zonën e shërbimi (furnizim 24 orë në ditë me ujë për të gjithë),
- Të sigurohet presioni i nevojshëm në gypat e ujësjellësit në disa pjesë të kryeqytetit dhe vendbanime të tjera të cilat janë në zonën e shërbimit të KRU Prishtina,
- Zhvillimi i programeve me qëllim të zvoglimit të humbjeve të ujit,
- Ngritja e shkallës së arkëtimit,
- Përforcimi dhe ngritja e profilit të qendrave të konsumatorëve në mënyrë që të përmirësohen shërbimet ndaj tyre,
- Zvogëlimi i shpenzimeve të energjisë,
- Vendosja e ujëmatësve individual dhe sigurimi i funksionalitetit të atyre ekzistues,
- Përmirësimi i sistemit për menagjimin e të dhënave dhe informatave (SMI),
- Instalimi dhe zhvillimi i sistemit informativ gjeografik (GIS),
- Përmirësimi i faturimit dhe leximi i rregullt të ujëmatësve të konsumatorëve,
- Ndarja më e drejtë e faturimit në banesa kolektive të cilat faturohen me ujëmatës të përbashkët (në përpjestim me numrin e banorëve apo sipërfaqes së banesës).

KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.a

- Vendosja e ujëmatësve për prodhimin e ujit në të gjitha burimet,
- Vendosja e ujëmatësve individual me qëllim të përmirësimit të shkallës së konsumit të matur,
- Zhvillimi i programeve me qëllim të zvoglimit të humbjeve të ujit,
- Të përmirësohet norma e punës duke e ngritur efikasitetin e arkëtimit dhe duke i ulur shpenzimet operative,
- Zvogëlimin e shpenzimeve të energjisë,
- Ngritja qendrave të konsumatorëve në mënyrë që të përmirësohet kujdesi dhe shërbimi ndaj konsumatorëve,
- Të përmirësohet sistemi i menaxhimit të të dhënave dhe informacioneve.

KRU “Hidrodrini” Sh.a

- Përmirësimi i kualitetit të ujit me shtimin e masave për trajtimin e tij,
- Të shfrytëzohen mundësitë që me përkrahje të institucioneve dhe të donatorëve të ngritet mbulueshmëria e popullatës me kanalizim,
- Të ngritet shkalla e arkëtimit duke marrë masa të shtuara si teknike ashtu edhe administrative,
- Humbjet e larta të ujit duhet të reduktohet në nivele të pranueshme,
- Ndërmarrja e masave për zvogëlimin e shpenzimeve të larta të energjisë elektrike.

KRU “Mitrovica” Sh.a

- Të shfrytëzohen mundësitë që me përkrahje të institucioneve dhe të donatorëve të ngriten kapacitetet prodhuese, në mënyrë që të përmirësohet furnizimi i rregullt me ujë të pijes,
- Ngritja e qendrave të konsumatorëve në mënyrë që të përmirësohet shërbimet ndaj tyre,
- Zhvillimi i programeve për zvogëlimin e humbjeve të ujit,
- Të ngritet efikasiteti i arkëtimit,
- Zvogëlimi i shpenzimeve të energjisë, me implementimin e masave për ngritjen e efikasitetit të operimit me energji,
- Vendosja e ujëmatësve individual me qëllim të përmirësimit të shkallë së konsumit të matur.

KRU “Radoniqi” Sh.a

- Reduktimi i shpenzimeve të larta të personelit,
- Zvogëlimi edhe më tej i humbjeve të ujit deri në një nivel të pranueshëm,
- Rritja e konsumit të matur dhe e proporcionit të konsumatorëve me ujëmatës,
- Të ngritet norma e mbulimit të punës duke e përmirësuar shkallën e arkëtimit dhe zvogëlimin e shpenzimeve operative,
- Të përmirësohet efikasiteti i stafit.

KRU “Bifurkacioni” Sh.a

- Të përmirësohet kualiteti i ujit, me shtimin e masave për trajtimin e ujit të pijshëm.
- Vendosja e ujëmatësve individual me qëllim të përmirësimit të shkallës së konsumit të matur,
- Ndërmarrja e masave për zvogëlimin e humbjeve të ujit,

- Të ngritet efikasiteti i arkëtimit
- Reduktimi i shpenzimeve të larta të personelit.

KRU “Hidromorava” Sh.a

- Të rritet zona e mbulueshmërisë me ujësjellës dhe kanalizim, duke shfrytëzuar mundësitë që janë ofruar me rritjen e kapaciteteve prodhuese,
- Të përmirësohet edhe më tej kualiteti i ujit të distribuar te konsumatorët,
- Vendosja e ujëmatësve individual me qëllim të përmirësimit të shkallës së konsumit të matur,
- Zhvillimi i programeve me qëllim të zvogëlimit të humbjeve të ujit,
- Të ndalet trendi negativ i shkallës së arkëtimit me ngritjen e efikasiteti të faturimit dhe inkasimit të hyrave nga faturat e konsumatorëve,
- Të zhvillohet sistemi i menaxhimit të dhënave dhe informacioneve,
- Të shtohet kujdesi ndaj konsumatorëve me zgjedhjen me kohë të kërkesave dhe ankesave të tyre,
- Përmirësimi i efikasitetit të stafit.

Pjesa C

Performanca Krahase e Sektorit të Mbeturinave

10. PERFORMANCA E PËRGJITHSHME E SEKTORIT TË MBETURINAVE

10.1. Performanca e përgjithshme e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave

Ngjashëm me sektorin e ujit edhe sektori i grumbullimit të mbeturinave është i organizuar në baza rajonale. Shërbimet e grumbullimit të mbeturinave ofrohen nga shtatë kompani rajonale të cilat janë nën mandatin rregullator të ZRRUM-it.

Në tabelën 15, është dhënë një profil i shkurtër i kompanive rajonale, së bashku me shkurtesat e emrave të tyre të cilat përdoren në këtë raport.

Tabela 15. Profili i kompanive rajonale të mbeturinave

Emri i kompanisë	Komunat në zonën e shërbimit	Popullata totale në zonën e shërbimit	Popullata e shërbyer	Numri i konsumatorëve	Grumbullimi total në ton	Shkurtesat e përdorura
KRM Pastrimi, Sh.a	6	548,370	291,180	49,124	88,445	Pastrimi
KRM Ekoregjioni, Sh.a	5	458,284	174,826	25,999	42,946	Ekoregjioni
KRM Ambienti, Sh.a	3	201,270	72,071	21,841	23,177	Ambienti
KRM Uniteti, Sh.a	3	211,897	63,727	11,596	34,196	Uniteti
KRM Çabrati, Sh.a	1	97,931	51,163	10,772	16,964	Çabrati
KRM Higjena, Sh.a	3	207,385	68,274	16,353	21,909	Higjiena
KRM Pastërtia, Sh.a	2	178,721	78,272	17,990	18,324	Pastërtia
Totali	23 ¹²	1,903,858	799,514	153,675	245,961	

Numri i popullatës të cilëve ju ofrohen shërbimet e mbeturinave është 799,514 banorë (ose 42% e popullatës totale në zonën e shërbimit).

¹² Komuna e Deçanit, Kaçanikut dhe e Vitisë me vendime të Kuvendeve Komunale të tyre janë larguar nga Kompanitë Rajonale, ato operojnë pa licencë prej ZRRUM-it.

Ndërmarrjet Komunale në pjesën veriore të Mitrovicës si dhe Komunat ajo e Shtërpçës dhe Novobërdës nuk janë pjesë e rajonalizimit dhe janë ende jashtë mandatit rregullator të ZRRUM-it.

Popullata e shërbyer me shërbime është përlogaritur duke shumëzuar numrin e konsumatorëve shtëpiak me numrin mesatar të anëtarëve të familjes për komunën përkatëse (sipas të dhënave të marra nga Enti Statistikor i Kosovës).

Numri total i konsumatorëve të regjistruar nga shtatë KRM në vitin 2009 është 153,675, ku përfshihen kategoritë e konsumatorëve shtëpiak, komercial-industrial dhe atyre institucional.

Sasia totale e grumbullimit të mbeturinave nga shtatë KRM-të në vitin 2009 është 245,961 ton. Prej kësaj sasive 205,626 ton janë deponuar në deponitë e licencuara, ndërsa 40,335 ton në deponitë e pa licencuara. Kjo ka të bëjë kryesisht me atë se Çabрати dhe disa njesi operative të KRM edhe në vitin 2009 kanë vazhduar ti deponojë mbeturinat në deponi të palicencuara.

10.2 Performanca dhe rangimi i kompanive rajonale të mbeturinave

Tabela 16. Niveli i arritur i TKP të kompanive dhe mesatarja e sektorit në 2009

Kompanitë rajonale të mbeturinave	Shkalla e arkëtimit (%)	Norma e mbulimit të punës (koeficient)	Ankesat e konsumatorëve (nr./1000kons.)	Kostot njësi (€/t)	Efikasiteti i stafit (staf/1000 kons.)
Pastrimi	51	0.92	10.52	31.87	9.04
Ekoregjioni	63	0.84	7.08	37.34	9.08
Ambienti	53	0.95	0.78	31.18	7.05
Uniteti	56	0.73	2.59	22.73	15.52
Çabрати	50	0.82	8.91	29.80	10.68
Higjiena	62	0.86	4.40	35.39	8.62
Pastërtia	51	0.87	0.00	40.67	8.50
Mesatarja	55	0.87	5.96	32.32	9.26

Tabela 17. Performanca e sektorit për vitet 2008-2009

Kompanitë rajonale të mbeturinave	Shkalla e arkëtimit (%)	Norma e mbulimit të punës (koeficient)	Ankesat e konsumatorëve (nr./1000kons.)	Kostot njësi (€/t)	Efikasiteti i stafit (staf/1000 kons.)	Rritja e numrit të konsumatorëve (%)
Sektori në 2008	61	0.87	7.16	33.90	9.28	1.07
Sektori në 2009	55	0.87	5.96	32.32	9.26	2.33
Trendi	negativ	njëjtë	pozitiv	pozitiv	pozitiv	pozitiv

Nga treguesit e paraqitur më lartë, në vitin 2009, vetëm njëri ka treguar trend negativ i cili është Shkalla e arkëtimit. Megjithatë Norma e mbulimit të punës ka ngelur e pandryshuar nga 2008; kjo është një provë e kontrollimit të mirë të shpenzimeve nga KRM siç mund të vërehet në zvogëlimin e shpenzimit tek treguesi Kostoja për njësi.

Për vlerësimin e performancës më të mirë të kompanive rajonale të mbeturinave, ZRRUM-i ka përzgjedhur disa prej TKP më me rëndësi në bazë të të cilëve është bërë poentimi dhe rangimi i tyre, e të cilët përfshihen në tabelën 18.

Tabela 18. Pesha e treguesve

Treguesi	Rëndësia
Shkalla e arkëtimit	1.0
Norma e mbulimit të punës	1.0
Ankesat e konsumatorëve	1.0
Kostoja për njësi	0.8
Efikasiteti i stafit	0.8
Rritja e numrit të konsumatorëve	0.2

Në përputhje me metodologjinë e aprovuar për vlerësimin e performancës, TKP i është dhënë një rëndësi e cila është ndarë në tri kategori:

(i) me 1.0 pikë janë peshuar dy tregues më të rëndësishëm financiar dhe një i nivelit të shërbimit, **(ii)** me 0.8 pikë janë peshuar një tregues financiar dhe një operativ si dhe **(iii)** me 0.2 pikë është vlerësuar progresi, në rritjen e numrit të konsumatorëve prej vitit në vit, edhe pse ky nuk është ndonjë tregues i mirëfilltë atij i është dhënë një peshë simbolike vetëm për të nxitur kompanitë të bëjnë përpjekje për të regjistruar konsumatorët të ri dhe është përdorur vetëm tek vlerësimi i performancës për progresin e arritur gjatë vitit vlerësues 2009 në krahasim me vitin 2008.

Performanca e kompanive rajonale të mbeturinave për vitin 2009 përmes treguesve kyç të performancës është paraqitur në tabelën 19, ndërsa progresi i arritur në përmirësimin e performancës së gjatë viteve 2008-2009 është paraqitur në tabela 20.

Tabela 19. Numri i pikëve sipas treguesve të performancës në viti 2009

Kompanitë rajonale të mbeturinave	Shkalla e arkëtimit (%)	Norma e mbulimit të punës (koeficient)	Ankesat e konsumatorëve (nr./1000kons.)	Kostot njësi (£/t)	Efikasiteti i stafit (staf/1000 kons.)	Totali i pikëve
Pastrimi	0.07	0.86	1.00	0.39	0.61	2.93
Higjiena	0.89	0.59	0.31	0.24	0.65	2.68
Ambienti	0.23	1.00	0.06	0.42	0.80	2.51
Ekoregjioni	1.00	0.48	0.17	0.15	0.61	2.41
Çabрати	0.00	0.42	0.64	0.48	0.46	2.00
Uniteti	0.42	0.00	0.18	0.80	0.00	1.40
Pastërtia	0.04	0.62	0.00	0.00	0.66	1.32

Totali i pikëve të grumbulluara për një kompani paraqet shumën e pikëve të mbledhura për secilin tregues. Ndarja e pikëve për performancën më të mirë për vitin 2009 si dhe për progresin e arritur në përmirësimin e performancës për periudhën 2008-2009 është bërë në bazë të metodës së njëjtë të përdorur edhe gjatë poentimit të viteve të kaluara, e cila bazohet në ndarjen proporcionale të pikëve varësisht nga niveli i arritur në një tregues. Kështu për kompaninë që ka arritur nivelin më të lartë në një tregues i është dhënë maximumi 1.0 pikë, përderisa për kompaninë që ka pasur nivelin më të ulët në atë tregues i është ndarë minimumi 0.0, ndërsa kompanitë e tjera kanë marrë proporcionalisht pikë në mes 0.0 dhe 1.0 varësisht prej nivelit të arritur në atë treguesi.

Tabela 20. Numri i pikëve sipas treguesve të performancës në 2008-2009

Kompanitë rajonale të mbeturinave	Shkalla e arkëtimit (%)	Norma e mbulimit të punës (koeficient)	Ankesat e konsumatorëve (nr./1000kons.)	Kostot njësi (€/t)	Efikasiteti i stafit (staf/1000 kons.)	Rritja e numrit të konsumatorëve (%)	Totali i pikëve
Uniteti	0.78	0.12	0.56	0.80	0.56	0.07	2.89
Higjiena	0.77	1.00	0.56	0.49	0.00	0.05	2.87
Ekoregjioni	1.00	0.68	0.06	0.06	0.55	0.00	2.35
Ambienti	0.44	0.15	0.19	0.37	0.80	0.20	2.15
Çabрати	0.22	0.00	0.75	0.57	0.46	0.04	2.04
Pastërtia	0.00	0.24	0.00	0.43	0.75	0.11	1.53
Pastrimi	0.44	0.04	0.25	0.00	0.62	0.08	1.43

Për vlerësimin e progresit në përmirësimin e performancës për peiudhën 2008-2009 është përdorur metoda e njëjtë e poentimit si te performanca e vitit 2009 me ndryshimin se tani në vlerësim janë marrë parasysh 6 tregues kyç të performancës.

Tab. 21. Rangimi i kompanive sipas performancës në vitin 2009

Pozita	Kompanitë rajonale të mbeturinave	Pikët e mbledhura
1	Pastrimi	2.93
2	Higjiena	2.68
3	Ambienti	2.51
4	Ekoregjioni	2.41
5	Çabрати	2.00
6	Uniteti	1.40
7	Pastërtia	1.32

Tabela 22. Rangimi i kompanive sipas përmirësimit të performancës 2008-2009

Pozita	Kompanitë rajonale të mbeturinave	Pikët e mbledhura
1	Uniteti	2.89
2	Higjiena	2.87
3	Ekoregjioni	2.35
4	Ambienti	2.15
5	Çabrati	2.04
6	Pastërtia	1.53
7	Pastrimi	1.43

Tabela 22 përmbledh vlerësimin e përmirësimeve të bëra gjatë vitit 2009 krahasuar me vitin 2008. Përmirësime më të dukshme vërehen te Uniteti dhe këtë në shkallën e arkëtimit, efikasitetin e stafit, ankesat ndaj shërbimeve për ‘1000 konsumatorë, shpenzimet për njësi, ndërsa në normën e mbulesës së punës ka pasur përkeqësime.

Përmirësime të kufizuara në këta tregues janë në Ekoregjion dhe në Çabrat.

Kompania me performancën më të dobët në vitin 2009 krahasuar me vitin 2008 është Pastrimi.

Tabela 23. Rangimi i kompanive gjatë viteve 2006-2009

Kompanitë rajonale të mbeturinave	Rangimi 2006	Rangimi 2007	Rangimi 2008	Rangimi 2009
Pastrimi	6	6	1	1
Ekoregjioni	4	4	5	4
Ambienti	5	3	3	3
Uniteti	7	1	7	6
Çabrati	1	2	2	5
Higjiena	3	5	6	2
Pastërtia	2	7	4	7

Nga tabela 23 shihet se Pastrimi ka ruajtur pozicionin e parë nga viti i kaluar edhe pse ka pasur një trend të lehtë të rënies në disa prej tregueseve kyç të performancës.

Ambienti po ashtu ka mbetur stabil gjatë vitit 2008 dhe 2009 pas progresit të arritur në vitin 2007.

Çabрати gjatë viteve ka një trend negativ dhe nga pozicioni i parë në vitin 2006, mandej në pozicionin e dytë në vitin 2007- 2008, në vitin 2009 është ranguar në pozitën e pestë dhe është mjaft shqetësuese se edhe më tej ka rënie, e cila vërehet edhe nga rangimi në pozitën po ashtu të pestë në progresin e arritur gjatë vitit 2008 në vitin 2009.

Higjiena është kompania që ka shënuar ngritjen më të lartë në vitin 2009 duke u ranguar në pozitën e dytë në krahasim me vitin 2008 që ishte e ranguar në pozitën e gjashtë.

11. PERFORMANCA KRAHASUESE E KOMPANIVE RAJONALE TË MBETURINAVE

Për të mundësuar një krahasim kuptimplotë, për kompanitë publike të shërbimeve të mbeturinave janë paraqitur të dhëna në tabela dhe grafe të shoqëruara edhe me analizë tekstuale për 9 tregues prej të cilëve 6 paraqesin treguesit kyç të performancës, përmes të cilëve është bërë edhe vlerësimi dhe rangimi i kompanive për performancën më të mirë në vitin 2009, si dhe për progresin më të madh të shënuar në vitin 2009 krahasuar me vitin 2008.

Treguesit kyç të performancës për sektorin e mbeturinave janë:

- Shkalla e arkëtimit
- Norma e mbulimit të punës
- Ankesat e konsumatorëve
- Kostoja për njësi
- Efikasiteti i stafit
- Rritja e numrit të konsumatorëve

Përshkrimi i treguesve është bërë duke i grupuar në katër kategori


- Treguesit operaiv
- Treguesit e nivelit të shërbimit
- Treguesit financiar
- Treguesit e efikasitetit të stafit

11.1 Treguesit operaiv

11.1.1 Mbulueshmëria me shërbime të mbeturinave

Definicioni: *Popullsia që ka qasje në shërbimet e grumbullimit të mbeturinave në raport me popullsinë e regjistruar në regjionin e mbuluar, shprehur si përqindje.*

Në vitin 2009 në mungesë të statistikave të sakta në lidhje me regjistrimin e popullatës në Kosovë, ZRRUM ka shfrytëzuar të dhënat nga Enti i Statistikave të Kosovës (ESK) për të përfituar në mënyrë të tërthortë, të dhënat në lidhje me numrin e popullatës që jeton në regjionet ku ofrohen shërbimet e grumbullimit të mbeturinave. Ndërsa, të dhënat për popullatën e shërbyer nga KRM, janë fituar përmes shumëzimit të numrit të faturave të lëshuara për kategorinë e konsumatorëve shtëpiak me koficientin e marrë nga ESK të numrit të anëtarëve në një ekonomi familjare për regjionet përkatëse.



Grafi 19. Mbulueshmëria me shërbimet e grumbullimit të mbeturinave


Mbulimi me shërbime nga shtatë kompanitë e grumbullimit të mbeturinave mbetet prapë në nivel të ulët, edhe pse mesatarja e mbulimit me shërbime të mbeturinave është ngritur nga 39% në 42%.

Nga diagrami 19 shihet se Pastrimi e ka nivelin më të lartë të shtrirjes me shërbime me 53%, ndërsa Uniteti ka nivelin më të ulët të shtrirjes me 29%.

Të të gjitha kompanitë vërehet një ngritje e shtrirjes me shërbime të grumbullimit të mbeturinave përveç te Çabрати dhe Ekoregjioni në të cilat niveli i shtrirjes me shërbime ka rënë, kjo si pasojë e zvogëlimit të numrit të popullatës së shërbyer.

11.1.2 Grumbullimi i mbeturinave për punëtorë

Definicioni: Totali i grumbullimit të mbeturinave në raport me numrin total të punëtorëve.




Grafi 20. Sasia e grumbullimit të mbeturinave për punëtorë

Në vitin 2009 krahasuar me vitin 2008 është konstatuar kryesisht një rritje e efikasitetit të grumbullimit të mbeturinave në pesë prej shtatë kompanive të mbeturinave. Rritja e efikasitetit të grumbullimit të kompanit Pastrimi, Uniteti, Ambienti dhe Pastërtia ka ardhur si rezultat i rritjes së sasisë së mbeturinave. Ndërsa Ekoregjioni ka qenë më efikas në punë me po të njëjtin numër të punëtorëve.

Rënia e efikasitetit të grumbullimit të mbeturinave për punëtor në Higjien është për shkak të rritjes së numrit të punëtorëve si dhe zvogëlimit të sasisë së grumbullimit të mbeturinave, po ashtu rënie të efikasitetit kemi edhe te Çabrti si shkak i rritjes së numrit të punëtorëve dhe rritjes jo të mjaftueshme të sasisë së mbeturinave të grumbulluara.

11.1.3 Mbeturinat e deponuara në deponitë sanitare (licencuara)

Definicioni: Sasia e mbeturinave të deponuara në deponitë sanitare të licencuara në raport me tërë sasinë e mbeturinave të grumbulluara.



Grafi 21. Deponimi i mbeturinave në deponitë sanitare


Edhe viti 2009 regjioni i Gjakovës ka qenë pa deponi të licencuar dhe kompania tërë sasinë e mbeturinave të grumbulluara e ka hedhur në deponi të palicencuar (deponi e egër). Ndërsa kompanitë rajonale të mbeturinave si Uniteti, Higjiena dhe Ekoregjioni sipas të dhënave të tyre, i shfrytëzojnë vetëm deponitë e licencuara për hedhjen e mbeturinave.

Mesatarja e mbeturinave të deponuara në deponitë sanitare është 84%, ndërsa sasia tjetër e mbeturinave diku rreth 40,335 ton, shumica nga Çabrat është deponuar në deponi të palicencuar, duke përfshirë edhe disa nga njësitë operative të kompanive rajonale të mbeturinave.

11.2 Treguesit e nivelit të shërbimit

11.2.1 Ankesat e konsumatorëve

Definicioni: Numri i ankesave ndaj shërbimeve ndarë për '000 konsumatorë të regjistruar.




Grafi 22. Ankesat për '000 konsumatorë

Shkalla e ankesave për shërbimet e mbeturinave për një mijë konsumatorë është rritur në vitin 2009 në 5.96 në raport me vitin 2008 kur mesatarisht ishin 4.92 ankesa. Pastrimi ka regjistruar numrin më të madh të ankesave për vitin 2009 me 10.52 ankesa për një mijë konsumatorë, Pastërtia nuk ka të raportuar asnjë ankesë, përderisa Ambienti në vitin 2009 i ka trajtuar në mënyrë më serioze ankesat ku edhe ka mbajtur një regjistër me të mirë të tyre në krahasim me vitin 2008.

11.3 Treguesit financiar

11.3.1 Shkalla e arkëtimit

Definicioni: Shuma në euro e të hyrave të arkëtuara për periudhën e caktuar (pa TVSH) në raport me shumën në euro të të ardhurave të faturuara për të njëjtën periudhë (pa TVSH).



Grafi 23. Përqindja e arkëtimit


Siç shihet nga grafi 23 shkalla e arkëtimit ka rënë në përgjithësi në vitin 2009 krahasuar me vitin 2008, në mesatare të sektorit, ka pësuar rënie të dukshme

Për dallim nga kompanitë tjera, këtë vit vetëm Ekoregjioni ka shënuar rritje të shkallës së arkëtimit nga 60% në 63%.

Ky është trend shumë shqetësues dhe ZRRUM pret përmirësime në 2010

11.3.2 Shpenzimet operative për njësi

Definicioni: Totali i shpenzimeve operative në raport me totalin e mbeturinave të grumbulluaran në ton.




Grafi 24. Shpenzimet operative (€/t)

Nga grafi 24 shifet se mesatarja e përgjithshme e kostos së mbeturinave të grumbulluara për shtatë kompanitë për vitin 2009 është 32.32Euro për ton, gjë që do të thotë se kemi një rënie prej 1.58Euro për ton, krahasuar me vitin 2008 që ishte 33.90 Euro për ton.

Në të gjitha kompanitë rajonale të mbeturinave rënia e shpenzimeve për njësi në vitin 2009 ka ardhë kryesisht si rezultat i sasisë më të madhe të mbeturinave të grumbulluara dhe zvogëlimit të shpenzimeve operative, duke përfshirë: derivatet, taksat e deponimit të mbeturinave, riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve dhe shpenzimet tjera.

11.3.3 Norma e mbulimit të punës

Definicioni: Të hyrat operative të arkëtuara nga faturat e lëshuara dhe nga të ardhurat operative ndarë për shpenzimet totale operative.




Grafi 25. Norma e mbulimit të punës

Grafi 25 tregon se në shumicën prej kompanive rajonale të mbeturinave norma e mbulimit të punës në vitin 2009 është më e ulët krahasuar me vitin 2008, dhe që pasqyron gjendje negative financiare dhe nevojë për subvencione.

Dy kompanitë si Ekoregjioni dhe Higjiena kanë treguar përmirësim të dukshëm në vitin 2009. Performanca në nivel të sektorit nuk ka ndryshuar krahasuar me 2008 që tregon se të gjitha kompanitë e mbeturinave vazhdojnë të operojnë në nivel të paqëndrueshëm financiar.

11.3.4 Norma e punës

Definicioni: Të ardhurat operative nga faturat e lëshuara dhe nga të ardhurat tjera operative ndarë për shpenzimet totale operative pa amortizim



Grafi 26. Norma e punës

Sikurse vërehet nga grafi 26, në vitin 2009, norma e punës sillet nga 1.21 deri në 1.68.


Mesatarja e normës së punës prej 1.30 në vitin 2008 ka treguar ngritje të lehtë në 1.37 në vitin 2009 si rezultat i ngritjes së vlerës së faturimit njëkohësisht edhe i të hyrave të tjera të arkëtuara në disa nga Kompanitë.

Njëra nga kompanitë, Pastërtia, ka arritur përmirësim të dukshëm prej 1.23 në 2008 në 1.68 në 2009. Megjithatë vërehet se Pastërtia ka dështuar të konvertoj suksesin e faturimit të paraqitur më lartë në përmirësimin e arkëtimit paraqitur në diagramin e mëhershëm të Normës së mbulimit të punës.

11.4 Efikasiteti i stafit

11.4.1 Stafi për një mijë konsumatorë (1000)

Definicioni: Numri total i stafit ndarë për njëmijë konsumatorë.



Grafi 27. Efikasiteti i stafit për 1000 konsumatorë

Rezultatet e bazuara në të dhënat e vitit 2009 tregojnë se numri mesatar i stafit për njëmijë konsumatorë është 9.26 që paraqet një përmirësim të vogël krahasuar me vitin 2008 kur ky tregues ishte 9.28.

Rritja e efikasitetit të stafit prej katër nga shtatë kompanitë nga vitit në vit është rezultat i rritjes të numrit të konsumatorëve. Kompania më e mirë në këtë tregues është Ambienti me 7.05.

Gjashtë kompanitë tjera regionale të mbeturinave duhet të synojnë së paku arritjen e këtij treguesi sikurse Ambienti. Performuesi më i dobët në këtë tregues, ashtu si në vitin e mëparshëm është Uniteti me 15.52. Nuk është e qartë për ZRRUM se pse Uniteti performon dukshëm më ulët në këtë tregues, krahasuar me kompanitë tjera. ZRRUM do të hulumton këtë gjatë vitit 2010.

12. PERFORMANCA E KOMPANISË SË DEPONIMIT TË MBETURINAVE

Kompania për menaxhimin e deponive në Kosovë (KMDK), është ndërmarrje publike në pronësi të Republike së Kosovës, e cila menaxhon me deponitë sanitare në regjionet e Prishtinës, Gjilanit, Prizrenit, Podujevës dhe me stacionin e transferit në Ferizaj. Konsumatorë të KMDK janë kompanitë rajonale të grumbullimit të mbeturinave Pastrimi, Higjiena, Pastërtia, Ekoregjioni dhe një numër i operatorëve privat.

Dy kompanitë rajonale Ambienti dhe Uniteti po ashtu kanë qenë të licencuar nga ZRRUM-i për menaxhimin e deponive regjionale në Pejë përkatësisht në Mitrovicë deri në vitin 2008, atëherë kur edhe ju është skaduar vlershmria e licencave, këto kompani aktualisht menaxhojnë me këto deponi sanitare të pa licencuar nga ZRRUM.

Deponitë sanitare të menaxhuara nga KMDK janë të gjitha në gjendje të keqe si pasojë e mos menaxhimit të duhur të tyre dhe pamundësisë që ajo nuk ka mundur ti arkëtojë borxhet nga kompanitë rajonale të grumbullimit të mbeturinave, të cilat deponojnë përqindjen më të madhe të të gjitha mbeturinave, ku për pasojë është shkaktuar pamundësia e operimit në deponi si dhe ndërmarrja e investimeve të nevojshme për mirëmbajtjen e tyre.

Vlerësimi i performancës së KMDK është paraqitur në vijim duke u bazuar në treguesit kryesor të performancës të përlogaritur nga të dhënat e raportuara nga kjo kompani.

Tabela 24. Performanca e kompanisë për menaxhimin e deponive të Kosovës

Treguesi	2008	2009	Trendi
Norma e punës	2.46	1.84	negativ
Norma e mbulimit të punës	2.05	0.82	negativ
Shkalla e arkëtimit (%)	83%	45%	negativ
Kostoja e operimit për njësi (€/t)	2.07	2.94	negativ

Gjatë vitit 2009 rreth 176,272 tonë mbeturina janë deponuar në deponitë e menaxhuara nga KMDK-ja, sasi kjo që është për 12% më e vogël se sa në vitin 2008 kur kjo sasi ishte 196,693 tonë.

Siç shihet në tabelën 24, performanca e KMDK në vitin 2009 krahasuar me vitin 2008 ka shënuar rënie në të gjithë treguesit financiar. Përkeqësimi i performancës është shkaktuar nga zvogëlimi substencial i shkallës së arkëtimit.

Shkalla e arkëtimit ka shënuar rënie në 45% për vitin 2009 nga 83% sa ishte në vitin 2008, e cila ka ndikuar që norma e mbulimit të punës të bie në 0.82, duke sjellur KMDK-në në pozitë të paqëndrueshme financiare

Pjesa D

Aktivitetet e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve

13. KOMISIONET KËSHILLUESE TË KONSUMATORËVE

Një ndër funksionet dhe përgjegjësitë më të rëndësishme të ZRRUM-it është edhe mbrojtja e qëndrueshme e interesave të konsumatorëve, duke u përkujdesur që shërbimet që atyre iu ofrohen nga kompanitë e licencuara të jenë në nivelin e standardeve të përcaktuara, dhe se ata kanë në dispozicion mekanizma efektiv për adresimin e ankesave dhe pakënaqësive të tyre.

Me qëllim të realizimit të drejtave dhe të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi, përkatësisht me Nenin 6.1 të Rregullës për Komisionin Këshillues të Konsumatorëve për Shërbimet e Ujit dhe Mbeturinave në Kosovë (ZRRUM-R-08/ W & S W) është paraparë formimi i komisioneve këshilluese të konsumatorëve (KKK) si dhe janë përcaktuar modalitetet dhe funksionimi i këtyre komisioneve. Në harmoni me këto dispozita, ZRRUM-i në fund të vitit 2005 pas shqyrtimit të propozimeve nga Kuvendet Komunale, ka bërë themelimin e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve në 7 regjione të Kosovës sipas Planit për Konsolidimin e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave.

Secila komunë brenda regjionit të përcaktuar i ka dy përfaqësues në Komisionet respektive. Numri i përgjithshëm i anëtarëve të KKK është 52.

Roli dhe përgjegjësitë e KKK konsistojnë në:

- (i) Zgjidhjen e ankesave të parashtruara nga konsumatorët të cilat nuk janë trajtuar dhe zgjidhur nga ofruesit e shërbimeve në mënyrë të drejtë për Konsumatorin,
- (ii) Me kërkesë të Rregullatorit drejton sondazhe, studime dhe anketime lidhur me standardet e shërbimeve, dhe
- (iii) Ofron këshilla për Rregullatorin lidhur me tarifat e shërbimeve.

Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve janë takuar në mënyrë të rregullt në baza mujore dhe gjerë më tani janë mbajtur gjithsejtë 371 takime në cilat janë shqyrtuar çështje shumë të rëndësishme sikurse janë, shqyrtimi i ankesave të konsumatorëve, dhe aspekte të ndryshme si, propozimi i tarifave, harmonizimi i akteve normative me ligjin, etj.

Nga të gjitha takimet e mbajtura deri në fund të vitit 2009, janë shqyrtuar mbi 179 ankesa të parashtruara nga konsumatorët, prej të cilave 59 janë zgjidhur ndërsa të tjerat janë kthyer tek kompanitë për rishqyrtim të mëtejshëm.

KKK në regjionin e Gjakovës dhe Prishtinës kanë qenë më aktivet dhe nga totali i të gjitha ankesave drejtuar KKK ku rreth 95% për vitin 2008 dhe 81% për vitin 2009 janë nga këto dy regjione.

Nga totali i ankesave të parashtruar në KKK në vitin 2008 janë zgjedhur 71% ndërsa në vitin 2009 rreth 61%.

Natyra e Ankesave të parashtruar kryesisht kanë të bëjnë me kërkesat për zbritjen/shlyerjen e borxheve, faturimin paushallë si dhe në tarifa të larta.

Tabela 25. Numri i ankesave të parashtruara në KKK

Komisionet këshilluse të konsumatorëve në regjione	Ankesa të parashtruar		Ankesa të zgjedhura	
	2008	2009	2008	2009
Prishtinë	7	11	5	6
Prizren	0	0	0	0
Pejë	1	1	1	1
Mitrovicë	0	1	0	1
Gjakovë	13	7	9	5
Gjilan	0	3	0	0
Ferizaj	0	3	0	3
Totali	21	26	15	16

Me qëllim të informimit të konsumatorëve dhe sensibilizimin e opinionit publik për rolin e KKK-ve, ZRRUM është angazhuar aktivisht në bashkëpunim me KKK-të rajonale që të promovohet roli i tyre përmes mjeteve të informimit në nivel lokal ashtu edhe në nivel nacional. Me qëllim të krijimit të kushteve për participim aktiv të konsumatorëve në çështjet që kanë të bëjnë me shërbimet publike të ujësjellësit dhe mbeturinave, ZRRUM-i përmes gazetave ditore ka bërë njoftim publik për orarin e takimeve mujore të KKK. Punën e KKK e kanë përcjell edhe mediat. Në këtë drejtim janë bërë përpjekje të mëtejshme me qëllim të informimit sa më të mirë të konsumatorëve. Po ashtu ZRRUM-i ka përgatitur dhe shpërndarë dy herë më shumë se nga 100.000 fletëpalosje në tri gjuhë, lidhur me të drejtat dhe obligimet e konsumatorëve dhe mundësitë për parashtrimin e ankesave.

Një aktivitet i veçantë në këtë drejtim ka qenë sondazhi i realizuar me qytetarët në lidhje me atë se sa ata janë të kënaqur me nivelin e shërbimeve të ofruara nga kompanitë publike, në fillim të vitit 2009 i cili është mbështetur nga KKK.

KKK kanë vazhduar të bashkëpunojnë ngushtë dhe të konsultohen me Kompanitë e ujësjellësit dhe mbeturinave si dhe me palët e tjera të interesit me çështjet të cilat kanë të bëjnë me punën e KKK, lidhur me mbrojtjen e interesave të konsumatorëve. Në këtë drejtim është zhvilluar një bashkëpunim i ngushtë me OJQ 'Konsumatori' si dhe me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë ku ZRRUM-i është i përfshirë në Programin për Mbrojtjen e Konsumatorit 2010-2014.

Meqenëse KKK, janë duke luajtur një rolë shumë të rëndësishëm në promovimin dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, si dhe faktit se ato janë një zëdhënës i fuqishëm në promovimin e rolit të ZRRUM-it, si autoritet i pavarur që ka përgjegjësi për rregullimin e veprimtarive të kompanive publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave në Kosovë, ZRRUM-it do të angazhohet edhe më tej në dhënien e mbështetjes dhe ngritjes së profilit të tyre.

Pjesa E

Rekomandimet

14. REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME

Për Kompanitë:

- Zhvillimi i planeve strategjike me objektiva të qarta si dhe hartimi i planeve të veprimit me qëllim të arritjes së progresit dhe objektivave të përcaktuara në planet strategjike,
- Ndërmarrja e reformave organizative të brendshme në kuptim të zhvillimit të menaxhimit me burime njerëzore, orientimi nga kontraktimi dhe përdorimi i burimeve të jashtme për disa aktivitetet të caktuara,
- Orientimi i investimeve për zvogëlimin e shpenzimeve operative siç janë: reduktimi i humbjeve të ujit, matja e sasisë së ujit të prodhuar dhe atij të distribuuar te konsumatorët, optimalizimi i kostove të energjisë,
- Përmirësimi i faturimit përmes zhvillimit të praktikave dhe zbatimit të masave që kanë të bëjnë me mbajtjen e regjistrave më të fuqishëm, zhvillimi i procedurave të faturimit, azhurimi i bazës së të dhënave të konsumatorëve, përdorimin e teknologjive të reja për regjistrimin e ujit të hargjuar,
- Ngritja e shkallës së arkëtimit përmes inkurajimit dhe nxitjes së stafit për të ndërmarrë funksionet e faturimit dhe të arkëtimit më me zellë,
- Instalimi dhe zhvillimi i sistemit të menaxhimit të informatave, si avancimi i sistemit financiar të informacionit (moduleve të pakove softverike financiare, piano dhe pronet), përdorimi i softverëve për relacione me konsumatorë (CRS), instalimi dhe zhvillimi i sistemit informativ gjeografik (GIS), sistemi i administrimit të aseteve, etj.

Për Qeverinë:

- Aprovimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor dhe forcimin e masave institucionale në sektorin e shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave,
- Hartimi i planit strategjik për ujëra dhe trajtim të ujërave të zeza si dhe planin strategjik nacional për menaxhimin e mbeturinave,
- Hartimi i politikave të qarta në lidhje me participimin e sektorit privat (PSP) në sektorin e mbeturinave,
- Krijimi dhe përkrahëja e planeve investive në sektorin e shërbimeve të ujit,
- Subvencionimi i KRU-të për konsumatorët që janë në gjendje të rëndë sociale,
- Mbështetja e kompanive publike në aspektet ligjore, në arkëtimin e borxheve ashtu edhe në aspektet operative.

Për Komunat:

- Hartimi i planeve zhvillimore për të mbuluar tërë popullatën me shërbime të ujësjellësit, kanalizimit dhe grumbullimit të mbeturinave,
- Zhvillimi i mekanizmave adekuat për të ju ndihmuar kompanive publike për arkëtimin e borxheve për shërbimet e ofruara,
- Ndihmë për kompanitë e shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave për ti përballuar sfidat e zhvillimit të shpejtë të urbanizimit.
- Ndërmarrja e aktiviteteve të inspektimit me qëllim që të ndihmohen kompanitë e ujit dhe të mbeturinave nga keqpërdorimet e ujit të pijes, hedhjes së mbeturinave jashtë hapësirave të përcaktuara, etj.

Rekomandimet e Kuvendit të Kosovës

Në mbledhjen e mbajtur të Kuvendit të Republikës së Kosovës në korrik të këtij viti me rastin e aprovimit të Raportit Vjetor të Punës së ZRRUM-it për vitin 2009 janë dhënë edhe rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e gjendjes në sektorin e shërbimeve të ujit dhe mbeturinave. Këto rekomandime caktojnë një përmbledhje të qartë të prioriteteve për ZRRUM-in në të ardhmen lidhur me përmirësimin e performancës së ofruesve të shërbimeve për ujë dhe mbeturina dhe janë si vijon:

Sektori i Shërbimeve të Ujit

- Qeveria dhe komunat duhet të vëjnë prioritetin e aktiviteteve të tyre në sektorin e ujit, përforcimin dhe mbikqyrjen e afarizmit të Kompanive Publike si dhe të investojnë në ngritjen e kapaciteteve prodhuese sidomos në KRU 'Prishtina' dhe KRU 'Mitrovica'.
- Përmesë TFU (Task Forca për Ujëra) duhet adresuar subvencionimin e rasteve sociale, involvimin e gjykatave për zgjedhjen e problemeve në këtë sektor siç janë: Arketimi i borgjeve për shërbimet e ofruara, mbështetja e kompanive në aspektet operative si në rastin e kyçjeve ilegale, dëmtime të infrastruktures, pengesat në leximin e ujëmatësave, pagesa e borgjeve të konsumatorit institucional, Komunat duhet të japin mbështetje përmes mekanizmave të saj sidomos në arkëtimin e borgjeve nga bizneset, hartimin i planeve komunale për zgjerimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit.
- Rregullatori për ujëra dhe mbeturina (ZRRUM), së bashku me të gjithë akterët e involvuar në sektorin e ujësjellësve të sigurojë ndikim të vazhdueshëm mbi bordet dhe menaxhmentin e kompanive të ujit për përmirësimin e treguesve të performancës, zvogëlimin e humbjeve të ujit (komerciale dhe teknike), vendosjen e ujëmatësve ku ekziston mundësia teknike tek banimet kolektive respektivisht ndalimi i faturimit

paushall (faturimi të bëhet sipas leximit të ujëmatësve), ndarja proporcionale e ujit (reduktimet e barabarta), nënshkrimi i kontratave të shërbimit Kompani –Konsumatorë, korigjimi i tarifave të shërbimit (për shkak të mospërmbljes së investimeve kapitale të planifikuara), kushtëzimi i donacioneve dhe granteve me performancën e mirë të kompanive, vazhdimi i monitorimit dhe vlerësimit krahasues, kushtëzimi i licencave për ofrimin e shërbimeve me plotësimin e standardeve të shërbimit, pagesa e taksës vjetore të licencimit në kohë për ZRRUM-in nga kompanitë e licencuara nga ZRRUM-i.

Sektori i Shërbimeve të Mbeturinave

- Komunitet të angazhojnë inspektoratet për luftimin e deponive të egra në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, të emrohen bordete në kompanitë e mbeturinave, të veprohet sipas pakos së Ahtisarit për kompanitë e grumbullimit të mbeturinave, të nënshkruhen kontratat e shërbimit Kompani- Kuvende Komunale, të ndihmohen kompanitë në inkasimin e faturave të shërbimit përmes mekanizmave administrativ komunal sidomos të biznesit dhe institucionet, si dhe akteret kryesor të definojnë çart politikat për involvimin e sektorit privat.
- Kompanitë të ngrisin përgjegjësitë në menagjimin e mbeturinave, të zhvillojnë kapacitetet për ngritjen e standardeve të shërbimit (shtimi i aktiviteteve javore për grumbullimin e mbeturinave), të bëhet ngritja e shkallës së faturimit dhe inkasimit, të bëjnë pagesat e faturave për deponim e mbeturinave ndaj KMDK-se, të bëjnë pagesat e borxheve ndaj ZRRUM-it për taksën vjetore të licencimit dhe të hartojnë plane për zgjerimin e zonës së shërbimit për grumbullimin e mbeturinave.
- KMDK (Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës) të ketë mbështetje financiare nga ana e Qeverisë për sanimin e gjendjes së deponive.

ZRRUM-i, po ashtu është rekomanduar të bëjë përmirësimin e strukturës organizative dhe materiale të sajë.

Shtojcat

SHTOJCA 1. TË DHËNAT STATISTIKORE**Tabela A.** Kompanitë rajonale të ujësjellësit

Të dhënat statistikore për KRU	Prishtina	Hidroregjioni Jugor	Hidrodrini	Mitrovica	Radoniqi	Hidromorava	Bifurkacioni	Totali i sektorit
Popullësia totale në region	579,812	389,586	243,841	211,897	166,629	262,864	147,279	2,001,908
Popullata e mbuluar me shërbime të ujësjellësit	467,052	191,489	184,708	134,765	161,602	86,104	85,929	1,311,648
Popullat e mbuluar me shërbime të kanalizimit	348,138	170,424	96,039	103,609	105,370	81,648	63,966	969,194
Prodhimi i ujit (m ³)	45,105,379	15,244,976	28,192,459	17,358,593	15,162,287	6,937,500	5,088,640	133,089,834
Uji i faturuar (m ³)	20,891,301	6,824,091	7,284,430	8,463,345	6,796,051	2,983,181	2,178,156	55,420,555
Numri i konsumatorëve sipas kategorisë	Amvisni	75,962	23,791	26,213	19,251	23,626	14,551	195,410
	Komercial-Industrial	9,886	3,931	4,378	1,757	3,385	1,686	26,939
	Institucione	643	309	305	306	219	262	2,248
Totali i konsumatorve të regjistruar	86,491	31,230	30,896	21,314	27,230	16,676	13,964	227,801
Vëllimi i ujit të matur (m ³)	18,748,503	5,942,157	6,746,189	5,987,032	5,397,172	2,314,147	1,422,002	46,557,202
Numri i konsumatorëve të faturuar sipas ujëmatësve	69,468	24,524	26,269	10,921	25,604	12,954	9,168	178,908
Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit (Km)	1,073	250	474	439	543	175	125	3,079
Gjatësia e rrjetit të kanalizimit (Km)	246	198	95	182	73	-	78	872
Numri i stafit (€)	497	189	176	219	218	145	92	1,536
Vlera e faturimit (€)	9,951,263	2,678,879	2,325,017	2,110,663	2,541,624	1,325,638	928,382	21,861,466
Vlera e arkëtimit (€)	6,457,949	1,614,192	1,403,846	1,082,279	1,748,934	840,452	562,307	13,709,959
Kostoja e operimit(€)	6,197,879	1,889,153	1,430,695	1,807,515	1,788,138	1,031,718	525,338	14,670,436

Tabela B. Kompanitë rajonale të mbeturinave

Të dhënat Statistike		Pastrimi	Ekoregjioni	Ambienti	Uniteti	Çabrat	Higjiena	Pastërtia	Totali i Sektorit
Popullsia totale në Regjion		548,370	458,284	201,270	211,897	97,931	207,385	178,721	1,903,858
Popullata e Mbuluar me Shërbime të Mbeturinave		291,180	174,826	72,071	63,727	51,163	68,274	78,272	799,514
Totali i Mbeturinave të Grumbulluara		88,445	42,946	23,177	34,196	16,964	21,909	18,324	245,961
Mbeturinat e Deponuar në Deponitë e Licencuara		72,629	42,946	19,606	34,196	-	21,909	14,340	205,626
Mbeturinat e Deponuar në Deponitë e Palicencuara		15,816	-	3,571	-	16,964	-	3,984	40,335
Numri konsumatorve sipas kategorisë	Amvisni	43,074	22,074	16,924	9,686	9,120	14,358	14,774	130,010
	Komercial-Industrial	5,800	3,691	4,610	1,795	1,550	1,783	3,263	22,492
	Institucione	261	234	307	115	102	220	36	1,275
Totali i konsumatorëve të regjistruar		49,135	22,999	21,841	11,596	10,772	16,361	18,073	153,777
Numri i Stafit (€)		444	236	154	180	115	141	153	1,423
Vlera e Faturimit (€)		2,900,250	1,644,951	931,445	874,190	479,889	708,839	1,227,948	8,767,512
Vlera e Arkëtimit (€)		1,479,570	1,036,250	494,364	485,200	240,456	436,671	622,328	4,794,839
Të hyrat tjera operative		1,110,985	302,867	191,851	80,884	174,393	22,990	228,884	2,112,854
Kostoja e Operimit (€)		2,818,918	1,603,531	722,602	777,226	505,564	775,265	745,171	7,948,277
Numri i automjeteve për transportin e mbeturinave		51	38	25	30	12	20	17	193

Tabela C. Ofruesi i ujit me shumicë (Ibër Lepenci)

Të dhënat statistikore	Gjithsejtë
Vëllimi ujit me shumicë të faturuar (m ³)	17,817,840
Faturimi për ujiin me shumicë (€)	323,244
Arkëtimi për ujiin me shumicë (€)	266,477
Kostoja e operimit për furnizimin e ujit me shumicë (€)	0.021
Numri i punëtorëve të angazhuar në furnizimin e ujit me shumicë	20

Tabela D. Kompania për menaxhimin e deponive në Kosovë (KMDK)

Të dhënat statistikore	Gjithsejtë
Mbeturinat e deponuara (ton)	76,727
Vlera e faturimit (€)	955,769
Vlera e arkëtimit (€)	427,536
Kostoja e operimit (€)	519,731

SHTOJCA 2. DETALET KONTAKTUESE

Tabela A. Kompanitë rajonale të ujësjellësit

Kompanitë rajonale të ujit	Emri i drejtorit	Numri i telefonit	E-mail adresa	Adresa e kompanisë
Prishtina	Skender Bublaku	038/540 749, lok.128	skender.bublaku@kurprishtina.com	Rr. Tahir Zajmi p.n, Prishtine 10000
Hidroregjioni Jugor	Besim Baraliu	029/244 150	besimbaraliu@hotmail.com	Rr.Vatra Shqiptare p.n, Prizren, 20000
Hidrodrini	Agron Tigani	039/432 355	a.tigani@hidrodrini.com	Rr.Gazmend Zajmi nr.5, Pejë 30000,
Mitrovica	Faruk Hajrizi	028/533 707	farukhajrizi@gmail.com	Rr.Bislim Bajgora p.n, Mitrovicë 40000
Radoniqi	Albert Zajmi	0390/320 503	albert_zajmi@yahoo.com	Rr.UÇK, nr.07, Gjakovë 50000
Hidromorava	Myrvete Hoti	0280/321 104	myrvetej@yahoo.com	Rr.UÇK p.n, Gjilan 60000
Bifurkacioni	Faton Frangu	0290/320 650	faton_frangu@yahoo.com	Rr. Enver Topalli, nr.42/A, Ferizaj, 70000
NPH Iber Lepenci	Hajdar Beqa	038/225 006	hajdarbeqa@gmail.com	Rr. Bill Clinton nr.13, Prishtine, 10000

Tabela B. Kompanitë rajonale të mbeturinave dhe kompania për menaxhimin e deponive në Kosovë

Emri i kompanisë	Emri i drejtorit	Numri i telefonit	E-mail adresa	Adresa e kompanisë
Pastrimi	Kadri Retkoceri	038/525 191	krm_pastrimi@yahoo.com	Rr. Bill Clinton p. n, Prishtinë 10000
Ekoregjioni	Xhemaili Haxhimustafa	029/244 753	krm_ekoregjioni@yahoo.com	Rr. Tahir Sinani nr. 59, Prizren 20000
Ambienti	Nexhat Abdullahu	039/434 729	krm_ambienti@yahoo.com	Rr. Fatmir Uka nr. 24, Pejë 30000
Uniteti	Rrustem Abiti	028/533 983	krm_uniteti@yahoo.com	Rr. Vllëzrit Dragaj p. n, Mitrovicë 40000
Çabрати	Përparim Radoniqi	0390/321 588	krm_cabrati@yahoo.com	Rr. Mazllom Lakuci p. n, Gjakovë 50000
Higjiena	Bajram Isufi	0280/324 040	krm_higjiena@yahoo.com	Rr. Adem Jashari nr. 111, Gjilan 60000
Pastërtia	Gazmend Bytyçi	0290/322 259	krm_pastrimi@yahoo.com	Rr. Enver Topalli nr. 44, Ferizaj
KMDK	Avni Ramadani	038/544 552	klmcavniramadani@gmail.com	Rr. Zija Shemsiu nr. 23, Prishtinë 10000

Tabela C. Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM)


ZRRUM	Emri	Numri i telefonit	E-mail adresa	Adresa e kompanisë
Drejtori	Raif Preteni	038/249 165/ 111	raif.preteni@wwro-ks.org	Rr. Ferat Dragaj nr.68, Prishtine, 10000
Zëvendës Drejtori	Kero Bardhaj	038/249 165/124	kero.bardhaj@wwro-ks.org	Rr. Ferat Dragaj nr.68, Prishtine, 10000
Kryesuese e departamentit të ligjit dhe licencave	Mejreme Cërnobregu	038/249 165/117	mejreme.cernobregu@wwro-ks.org	Rr. Ferat Dragaj nr.68, Prishtine, 10000
Kryesues i departamentit për monitorim të performancës dhe raportim	Qamil Musa	038/249 165/121	qamil.musa@wwro-ks.org	Rr. Ferat Dragaj nr.68, Prishtine, 10000
Kryesues i departamentit për tarifave dhe financa rregullatore	Sami Hasani	038/249 165/120	sami.hasani@wwro-ks.org	Rr. Ferat Dragaj nr.68, Prishtine, 10000
Kryesues i departamentit për administratë dhe financa	Ramiz Krasniqi	038/249 165/110	Ramiz.krasniqi@wwro-ks.org	Rr. Ferat Dragaj nr.68, Prishtine, 10000
Kontakti për konsumatorë	Sylë Sylë	038/249 165/ 124	syle.syla@wwro-ks.org	Rr. Ferat Dragaj nr.68, Prishtine, 10000

Tabela D. Komisionet regjionale këshilluese të konsumatorëve

Komisioni regjional	Kryesuesi i komisionit	Numri i telefonit
KKK Prishtinë	Mehdi Aliu	038/582 717
KKK Prizren	Zenel Ahmetaj	044/153-295
KKK Pejë	Ylfete Blakaj	044/276 538
KKK Mitrovicë	Tahir Islami	028/532 104
KKK Gjakovë	Flamur Vula	044/270 755
KKK Gjilan	Hevzi Matoshi	044/308 077
KKK Ferizaj	Bashkim Ferati	0290/321 297


SHTOJCA 3

Zonat e shërbimeve të kompanive rajonale të ujësjellësit



KUR Prishtina	KUR Hidroregjioni Jugor	KUR Hidrodrini	KUR Mitrovica	KRU Radoniqi	KRUK Bifurkacioni	KRUK Hidromorava	Komunat jashtë shërbimeve nga KUR-të
-Prishtina -Podujeva -Fushë Kosova -Obiliçi -Lipjani -Drenasi -Shtime	-Prizreni -Suhareka -Malisheva -Dragashi	-Peja -Klina -Istogu -Juniku -Deqani	-Mitrovica -Skenderaj -Vushtria	-Gjakova -Rahoveci	-Ferizaj -Kaçaniku	-Gjilani -Kamenica -Vitia	-Novoberda -Zubin Potoku -Leposaviqi -Shtërpca

Zonat e shërbimeve të kompanive rajonale të mbeturinave



KRM Pastrimi	KRM Ekoregjioni	KRM Ambienti	KRM Uniteti	KRM Çabrati	KRM Pastërtia	KRM Higjiena	Komunat jashtë shërbimeve nga KRM-të
							
-Prishtina -Podujeva -Fushë Kosova -Obiliçi -Lipjani -Drenasi	-Prizreni -Suhareka -Malisheva -Dragashi -Rahoveci	-Peja -Klina -Istogu -Deqani	-Mitrovica -Skenderaj -Vushtria	-Gjakova	-Ferizaj -Shtimja -Kaçaniku	-Gjilani -Kamenica -Vitia	-Novoberda -Zubin Potoku -Leposaviqi -Shtërpca

Falënderime

Kemi nderin dhe kënaqësinë që të ju shprehim mirënjohje dhe falënderime stafit menaxhues dhe tërë stafit tjetër të kompanive rajonale të ujit dhe të mbeturinave, NPH Ibër Lepenci, KMDK si dhe palëve të tjera të involvuar në procesin e raportimit për ZRRUM-in, për përkushtimin dhe bashkëpunimin e treguar, gjatë grumbullimit, procesimit dhe raportimit të të dhënave.

Kemi kënaqësinë që të falënderojmë stafin e IKSHPK-ës, për bashkëpunimin e treguar dhe dërgimin e të dhënave për kualitetin e uji të pijshëm.

Falënderime të veçanta shprehim për TFU-ë dhe këshilltarët e saj, NJPM-NP për bashkëpunimin me ZRRUM-in, si dhe ofrimin e informacioneve në lidhje me aktivitetet e këtyre dy institucioneve të rëndësishme në sektorin e shërbimeve të ujit.

Në mënyrë të veçantë falënderojmë, Zyrën Zvicrane për Bashkëpunim (SCO) për mbështetjen e ofruar ZRRUM-it, në programin e monitorimit të performancës së ofruesve të shërbimeve të ujit gjatë viteve, 2008- 2010 (për vitin e fundit gjashtë mujori i parë).

Në fund falënderojmë tërë stafin e ZRRUM-it si dhe konsulencën e projektit mbështetës për ZRRUM-in, (IP A e mbështetur nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian) për përkushtimin dhe angazhimin e treguar gjatë përpilimit të këtij raporti vjetor të performancës.

Zyra Rregullatore për Ujësjetellës dhe Mbeturina

Rr. Ferat Dragaj, 68

Prishtinë, Kosovë

Phone: 038/249 165

Fax: 038/249 165/129

E-mail: www.wwro-ks.org